

## GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

Çështja penale P Nr. 61/2016

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it, Iva Nikshiq, si kryetare e trupit gjykues, dhe gjyqtarët e EULEX-it Franciska Fiser dhe Rene Van Veen, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarjen e këshilltarit ligjor të EULEX-it, Dukagjin Kërveshi, si procesmbajtës, në Çështjen Penale P. Nr. 61/2016 kundër:

R.R.\_\_\_\_\_, me nofkën K.\_\_\_\_\_, emri i babës Z.\_\_\_\_\_, emri i nënës V.B.\_\_\_\_\_; i lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, banon në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_, qytetar i Kosovës; \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, i \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_; të ardhurat mujore \_\_\_\_ euro;

dhe

M.V.\_\_\_\_\_, nofka \_\_\_\_; emri i babës D.\_\_\_\_\_, emri i nënës M.\_\_\_\_\_; i lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_; banon në \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_, \_\_\_\_; profesioni: \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_; i \_\_\_\_\_, \_\_\_\_; të ardhurat mujore \_\_\_\_ - \_\_\_\_ euro;

Të dy të akuzuarit, përmes aktakuzës së prokurorit të shtetit në Mitrovicë të datës 7 maj 2014, që është ngritur pranë shkrimores së gjykatës më 8 maj të vitit 2014, dhe përmes aktakuzës së ndryshuar të datës 7 shtator 2016, janë akuzuar për veprat penale të:

1. **vrasjes së rëndë**, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147(4), (6), (8) dhe (10) të Kodit Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25 (KPK-së), në lidhje me nenin 23 të KPK-së, i *barasvlershëm* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të

Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit Nr. 04/L-082 (KPRK-së), në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

2. **vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë**, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147(4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, në lidhje me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së;
3. **mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve**, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 328 (1) dhe (2) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 374 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
4. **pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare**, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 409(1) dhe (2) të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
5. **rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme**, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 299 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 380(1) të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
6. **shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm**, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 291(1), (3) dhe (5) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 365 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
7. **pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale**, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 320 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 412 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor më 7, 14, 15, 19, 20 dhe 26 shtator të vitit 2016, 7, 10 dhe 17 tetor të vitit 2016 dhe 16 dhe 18 nëntor të vitit 2016, në praninë e prokurorit, palëve të dëmtuara D.Z. \_\_\_\_\_ dhe M.Z. \_\_\_\_\_ dhe përfaqësuesve të tyre Burhan Maxhuni dhe Eron Prekazi, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe mbrojtësve të tij Zhivojin Jokanovic dhe Nebojsha Vllajiq dhe të të pandehurve M.V. \_\_\_\_\_ dhe mbrojtësit të tij Agim Lushta;

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues, sipas nenit 366, paragrafit (1) të KPP-së, më 21 nëntor të vitit 2016, në një seancë publike dhe në praninë e prokurorit të shtetit, palëve të dëmtuara dhe përfaqësuesve të tyre dhe të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre;

Merr këtë:

## A K T G J Y K I M

I Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-së), i pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri M.V. \_\_\_\_\_ shpallen **të pafajshëm** dhe së këtejmi

## L I R O H E N

nga akuzat në vijim (pika 1 e aktakuzës):

Më 26 korrik të vitit 2011 midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me të pandehurit B.R. \_\_\_\_\_ (nofka D.1. \_\_), J.D. \_\_\_\_\_ dhe K.R. \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku, duke marrë pjesë së bashku dhe duke i kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendur – kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë të privimit ngajeta të E.Z. \_\_\_\_\_ për motive racore dhe kombëtare, për shkak të kombësisë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të tij, në kohën kur E.Z. \_\_\_\_\_ ka qenë duke e kryer detyrën e ligjshme të tij për ta mbrojtur rendin ligjor, duke e mbrojtur rendin ligjor, duke i ruajtur personat dhe pronat dhe duke e ruajtur rendin dhe qetësinë publike, dhe, kësisoj, e kanë rrezikuar me dashje jetën e bashkudhëtareve në veturë,

- dhe, duke vepruar kësisoj, e kanë kryer veprën penale të *vrasjes së mbetur në tentativë*, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, paragrafëve 4, 6, 8 dhe 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenet 178 dhe 179, pikat 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të Kodit Penal të vitit 2013 (KP 2013), në lidhje me nenin 31 të KP të vitit 2013.

**II** Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-së), i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ shpallen të pafajshëm dhe së këtejmi

## L I R O H E N

nga akuzat në vijim (pika 2 e aktakuzës):

Më 26 të korrikut të vitit 2011, midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe **M.V.** \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me të pandehurit **B.R.** \_\_\_\_\_ (nofka D.1.), **J.D.** \_\_\_\_\_ dhe **K.R.** \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku, duke marrë pjesë së bashku duke i kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendur – kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë për t'i privuar nga jeta bashkudhëtarët e tjerë (\_\_\_\_\_ **B.M.** \_\_\_\_\_ dhe **D.P.** \_\_\_\_\_) që kanë qenë në veturë me të ndjerin, përkatësisht palën e dëmtuar **E.Z.** \_\_\_\_\_, për motive racore dhe kombëtare për shkak të kombësisë \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të tij, në kohën kur **E.Z.** \_\_\_\_\_ ka qenë duke e kryer detyrën e ligjshme të tij për ta mbrojtur rendin ligjor, duke e mbrojtur rendin ligjor, duke i ruajtur personat dhe pronat dhe duke e ruajtur rendin dhe qetësinë publike, dhe, kësisoj, e kanë rrezikuar me dashje jetën e \_\_\_\_\_ **B.M.** \_\_\_\_\_, **D.P.** \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të tjerë të \_\_\_\_\_ që kanë qenë në karvanin e automjeteve në *locus in quo*,

- dhe, duke vepruar kësisoj, e kanë kryer veprën penale të *vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë*, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, paragrafëve 4, 6, 8 dhe 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenet 178 dhe 179, pikat 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të PK të vitit 2013, në lidhje me nenet 28 dhe 31 të PK të vitit 2013.

**III** Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP-së), i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ shpallen të pafajshëm dhe së këtejmi

## L I R O H E N

nga akuzat në vijim (pika 3 e aktakuzës):

Më 26 korrik të vitit 2011, midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me të pandehurit B.R. \_\_\_\_\_ (nofka D.1.\_\_\_\_), J.D. \_\_\_\_\_ dhe K.R. \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku dhe duke marrë pjesë së bashku dhe duke i kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të paligjshme të tyre, duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendor – kryerjes së veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armës që është përdorur për vrasjen e mbetur në tentativë të E.Z. \_\_\_\_\_, në kundërshti me ligjin e zbatueshëm që ka të bëjë me atë armë,

- dhe, duke vepruar kësisoj, e kanë kryer veprën penale të ***mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve***, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 328, paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 374 të PK të vitit 2013, në lidhje me nenin 31 të KPK-së 2013.

**IV** Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), i pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri M.V. \_\_\_\_\_ shpallen të **pafajshëm** dhe së këtejmi

## L I R O H E N

nga akuzat në vijim (pika 5 e aktakuzës):

më 26 korrik të vitit 2011, midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me të pandehurit B.R. \_\_\_\_\_ (nofka D.1. ), J.D. \_\_\_\_\_ dhe K.R. \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku dhe duke marrë pjesë së bashku dhe duke kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendor – e kanë shkatërruar, larguar dhe dëmtuar rëndë autostradën publike \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ në zonën që gjendet midis fshatrave \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, duke vënë shenja të gabuara, sinjale, pengesa dhe barrikada në rrugën publike të lartpërmendor dhe duke e rrezikuar kështu komunikacionin, jetën e njerëzve, sigurinë fizike dhe pronat në shkallë të lartë.

- Dhe, duke vepruar kësisoj e kanë kryer veprën penale të *rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme* që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 299, paragrafit 1 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 380 (1) të PK të vitit 2013 në lidhje me nenin 31 të PK të vitit 2013.

**V** Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), i pandehuri **R.R. \_\_\_\_\_** dhe i pandehuri **M.V. \_\_\_\_\_** shpallen **të pafajshëm** dhe së këtejmi

### L I R O H E N

nëga akuzat në vijim (pika 6 e aktakuzës):

më 26 korrik të vitit 2011, midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_**, në bashkëkryerje me të pandehurit **B.R. \_\_\_\_\_** (nofka D.1. \_\_), **J.D. \_\_\_\_\_** dhe **K.R. \_\_\_\_\_**, duke vepruar së bashku dhe duke marrë pjesë së bashku dhe duke kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendur – e kanë shkatërruar, larguar dhe dëmtuar rëndë autostradën publike \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_, në zonën që gjendet midis fshatrave \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, me armë, pengesa dhe bariera të tjera, të cilat e kanë shkaktuar vdekjen e **E.Z. \_\_\_\_\_** dhe i kanë shkaktuar dëme materiale substanciale autostradës publike dhe automjeteve të \_\_\_\_\_ si dhe rrezik të madh \_\_\_\_\_ të tjerë të \_\_\_\_\_ që kanë qenë të pranishëm në karvanin e automjeteve në *locus in quo*,

- dhe, duke vepruar kësisoj, e kanë kryer veprën penale të **shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm** që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 291 paragrafëve 1, 3 dhe 5 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 365 të KPK-së 2013, në lidhje me nenin 31 të KPK-së 2013.

**VI** Sipas nenit 364, paragrafit 1, pikës 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), i pandehuri **R.R. \_\_\_\_\_** dhe i pandehuri **M.V. \_\_\_\_\_** shpallen **të pafajshëm** dhe së këtejmi

## L I R O H E N

nga akuzat në vijim (pika 7 e aktakuzës):

Më 26 korrik të vitit 2011, midis orës 13:30 dhe 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me të pandehurit B.R. \_\_\_\_\_ (nofka D.1. \_\_\_\_), J.D. \_\_\_\_\_ and K.R. \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku dhe duke marrë pjesë së bashku dhe duke kontribuar substancialisht – nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të lartpërmendur – kanë marrë pjesë në turmën që është mbledhur në *locus in quo*, dhe që, përmes veprimit të mbledhjes së tyre, e kanë privuar ngajeta E.Z. \_\_\_\_\_, kanë shkaktuar rrezik të përgjithshëm, i kanë dëmtuar automjetet e \_\_\_\_\_ në shkallë të lartë dhe kanë kryer vepra penale të tjera të dhunës së rëndë kundër \_\_\_\_\_ \_\_\_\_\_ që kanë qenë të pranishëm në karvanin e automjeteve në *locus in quo*,

- dhe, duke vepruar kësisoj, e kanë kryer veprën penale të *pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale* që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 320, paragrafit 1 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, të barasvlershëm me nenin 412 të KPK-së 2013, në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

**VII** I pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri M.V. \_\_\_\_\_

## SHPALLEN FAJTORË

për akuzën sipas pikës 4 të aktakuzës, sepse është provuar se e kanë kryer veprimin në vijim:

Më 26 korrik të vitit 2011, midis orës 13:30 - 14:15, në zonën që gjendet midis fshatit \_\_\_\_\_ dhe fshatit \_\_\_\_\_ në komunën e \_\_\_\_\_, të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_, në bashkëkryerje me persona të tjerë, duke vepruar së bashku dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar substancialisht – përmes sjelljes dhe veprimeve të tyre të qëllimshme dhe të paligjshme të tyre dhe duke qenë pjesë e grupit të personave të cilët, gjersa karvani i \_\_\_\_\_, përkatësisht \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_), ka qenë duke lëvizur drejt Portës \_\_\_\_\_ – e kanë bllokuar rrugën me katër apo pesë automjete, e kanë krijuar një barrikadë dhe e kanë detyruar karvanin e \_\_\_\_\_ që të ndalej e pastaj janë konfrontuar me \_\_\_\_\_, duke bërtitur dhe duke bërë gjeste në drejtim të tyre për tu thënë që të

kthehesin prapa, pra nuk u janë bindur urdhrale të \_\_\_\_\_ që t'i largonin veturat, por kanë vazhduar të bërtisnin dhe t'i shanin këta zyrtarë, duke ua bërë me gjeste dhe duke ua ngritur tre gishta si dhe gishtin e mesëm dhe kur automjeti i blinduar i \_\_\_\_\_, sipas urdhrit të udhëheqësit të operacionit, i ka shtyrë tutje automjetet e barrikadës në mënyrë, në mënyrë që karvani i \_\_\_\_\_ së vazhdonte tutje, ata e kanë lënë barrikadën dhe kanë hyrë në pyll, duke shtënë nga aty në automjetet e \_\_\_\_\_ nga tri drejtime të ndryshme, me ç'rast njëri nga plumbat e ka qëlluar pjesëtarin e Njësisë \_\_\_\_\_, E.Z. \_\_\_\_\_, dhe kjo ka zgjatur derisa karvani është tërhequr prapa, duke lëvizur në drejtim të Mitrovicës,

- dhe, duke vepruar kësijoj, ata e kanë kryer veprën penale të *pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare* që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 318, paragrafit 2 të KPK-së. Së këtejmi, gjykata e ricilëson akuzën e parë për pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në kundërshti me nenin 316, paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 409, paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, sipas nenit 318, paragrafit (1) të KPK-së,

1. i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ së këtejmi

## DËNOSHET

**me 2 (dy) vite burgim,**

por, sipas nenit 43 paragrafit (1) dhe nenit 44, paragrafit (2) të KPK-së, **ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari R.R. \_\_\_\_\_ nuk kryen vepër penale tjetër gjatë periudhës së verifikimit prej 4 (katër) viteve.**

Sipas nenit 73, paragrafit (1) të KPK-së, koha e qëndrimit në paraburgim dhe e heqjes së lirisë në lidhje me **të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, përkatësisht nga 11 prilli i vitit 2014 deri më 22 prill të vitit 2015**, do të llogaritet për dënimin me burgim në rast të revokimit të dënitit me kusht dhe ekzekutimit të dënitit.

2. i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ së këtejmi

## DËNOSHET

**me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.**

por, sipas nenit 43 paragrafit (1) dhe nenit 44 paragrafit (2) të KPK-së, ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari M.V.\_\_\_\_\_ nuk kryen vepër penale tjetër gjatë periudhës së verifikimit prej 3 (tri) viteve.

**VIII** Sipas nenit 463, paragrafit (2) të KPP-së, palët e dëmtuara D.Z. \_\_\_\_\_, B.M. \_\_\_\_\_, D.P. \_\_\_\_\_ ftohen që të parashtrojnë kërkësë për kompensim në lidhje me këtë rast nëpërmjet gjykatave civile.

**IX** Sipas nenit 451, paragrafit (1) dhe nenit 453, paragrafëve (1) dhe (4) të KPP-së, i pandehuri R.R.\_\_\_\_\_ do t'i paguajë 400,00 euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës, por do të lirohet nga obligimi për t'i mbuluar shpenzimet e mbetur. I pandehuri M.V. \_\_\_\_\_ do t'i paguajë 300,00 euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës, por do të lirohet nga obligimi për t'i mbuluar shpenzimet e mbetur.

Të pandehurit duhet ta paguajnë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë pas ditës kur ky akt gjykim do të marrë formë të prerë.

## **A r s y e t i m**

### **Historiku i procedurës**

Më 8 maj të vitit 2014, Prokuroria e EULEX-it në Mitrovicë e ka ngritur Aktakuzën PP Nr. 103/2011 të datës 7 maj 2014 kundër të pandehurve R.R.\_\_\_\_\_ dhe M.V.\_\_\_\_\_, duke i akuzuar të dy për veprat penale të “vrasjes së mbetur në tentativë”, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, paragrafëve (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së; “vrasjes së rendë të mbetur në tentativë”, që është paraparë dhe penalizuar sipas neneve 146 dhe 147, paragrafëve (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së; “mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim dhe përdorim të paautorizuar të armëve”, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 328, paragrafëve (1) dhe (2) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së; “pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së; “rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”, që është paraparë

dhe penalizuar sipas nenit 299 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së; “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm”, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 291(1), (3) dhe (5) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së; dhe “pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale”, që është paraparë dhe penalizuar sipas nenit 320 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Procedura e parë e shqyrtimit gjyqësor në Çështjen Penale 59/2014 është filluar më 19 janar të vitit 2015 dhe është përfunduar më 20 prill të vitit 2015, me lirimin e të dy të pandehurve nga të gjitha akuzat kur është shpallur aktgjykimi. Bazuar në atë aktgjykim, të dy të akuzuarit, **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_**, janë shpallur të pafajshëm për të gjitha akuzat.

Më 8 qershor të vitit 2015, prokurori ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë.

Pas ankesës së prokurorit të EULEX të ushtruar kundër atij aktgjykimi, më 29 prill të vitit 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin e saj PAKR 355/2015, e ka aprovuar ankesën, e ka shpallur aktgjykimin dhe lënda i është kthyer Gjykatës Themelore të Mitrovicës për rigjykim.

Më 7 shtator të vitit 2016, procedura e shqyrtimit gjyqësor është rifilluar kundër të akuzuarve **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_**, këtë herë me numrin e rastit P. 61/2016. Aktgjykimi është shpallur më 21 nëntor të vitit 2016.

Sipas nenit 11, paragrafit (1) të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Në nenin 9, paragrin (2), nënparagrin (2.7) të të njëjtë Ligj thuhet se Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë. Bazuar në aktakuzën e ngritur, veprat penale të pretenduara janë kryer në Mitrovicë dhe, kësisoj, brenda kompetencës territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.

Sipas nenit 15, paragrafit (1), nënparagrat (1.11) të Ligjit për Gjykatat të përmendur më lart, veprat penale e “vrasjes së mbetur në tentativë” hyn në kompetencë të Departamentit për Krime Serioze të Gjykatës Themelore. Prandaj, i tërë rasti është gjykuar nga Departamenti për Krime Serioze. E njëjtë kompetencë është ruajtur edhe gjatë procedurës së rigjykimit dhe sipas ligjit të cekur më lart.

#### **Provat që janë paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim:

- \_\_\_\_\_ E.D. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 14 shtator të vitit 2016,
- \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 14 shtator të vitit 2016,
- \_\_\_\_\_ I.S. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 15 shtator të vitit 2016 dhe gjatë vizitës në terren më 7 tetor të vitit 2016;
- \_\_\_\_\_ N.S. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 15 shtator të vitit 2016,
- \_\_\_\_\_ S.S. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 15 shtator të vitit 2016,
- \_\_\_\_\_ D.P. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 19 shtator të vitit 2016,
- \_\_\_\_\_ F.U. \_\_\_\_\_ është dëgjuar më 20 shtator të vitit dhe më 10 tetor të vitit 2016 dhe
- \_\_\_\_\_, si ekspert, është dëgjuar gjatë vizitës në terren më 7 tetor të vitit 2016.

Më 7 tetor të vitit 2016, trupi gjykues e ka vizituuar vendin e ngjarjes në terren.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, palët kanë rënë dakord që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve në vijim, të cilat janë dhënë më parë gjatë shqyrtimit gjyqësor të parë në këtë rast:

- deklarata e dëshmitarit V.K. \_\_\_\_\_ e dhënë më 29 janar të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit F.Z. \_\_\_\_\_ e dhënë më 29 janar të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit M.J. \_\_\_\_\_ e dhënë më 30 janar të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit B e dhënë më 27 shkurt të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit F.F. \_\_\_\_\_ e dhënë më 9 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit I.L. \_\_\_\_\_ e dhënë më 9 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit B.M. \_\_\_\_\_ e dhënë më 9 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit B.P. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit K.H. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit M.S. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit F.A. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit G.C. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit H.H. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit K.K. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit A.I. \_\_\_\_\_ e dhënë më 17 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit G.D. \_\_\_\_\_ e dhënë më 17 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit V.R. \_\_\_\_\_ e dhënë më 17 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit S.V. \_\_\_\_\_ e dhënë më 17 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit Z.J. \_\_\_\_\_ e dhënë më 17 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit Z.M. \_\_\_\_\_ e dhënë më 18 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit S.V.1. \_\_\_\_\_ e dhënë më 18 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit M.K. \_\_\_\_\_ e dhënë më 18 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit Z.D. \_\_\_\_\_ e dhënë më 18 mars të vitit 2015,
- deklarata e dëshmitarit D.D. \_\_\_\_\_ e dhënë më 12 mars të vitit 2015.

Dokumentet në vijim janë pranuar si prova:

**INDEKSI-1 (dokumentet e policisë):**

1. Raporti i policisë PK#2063, faqet 10-11;
2. Raporti i TF-së-vendndodhja e \_\_\_\_\_ në raport, faqet 12-32;
3. Raporti fillestar/i incidentit, faqet 33-34;
4. Raporti i shpejtë përcjellës, faqet 35-38;
5. Raporti i shpejtë përcjellës, faqet 39-42;
6. Raporti informues- H. \_\_\_\_\_, faqet 45-48;
7. Informatat për të dyshuarit, faqet 49-54;
8. Qendra e Operimit dhe Komunikimit- “Kontrolli Bravo” 25-26.07.11;
9. Raporti përbledhës për incidentet, faqet 108-113;
10. Raporti përbledhës për ngjarjet, faqet 114-122;
11. Raporti i hetuesit-PK R.P. \_\_\_\_\_, faqet 123-124;
12. Raporti i hetuesit-PK R.G. \_\_\_\_\_, faqet 125-126;
13. Raporti informues, faqet 129-136;
14. Njësia Operative Speciale Mitrovicë, faqet 137-148;
15. Raporti i ekzaminimit të vendit të ngjarjes, faqet 149-164;
16. Raporti i vendit të ngjarjes, faqet 165-168;
17. Raporti përbledhës për ngjarjen, faqet 169-182;
18. Raporti i hetimit të vendit të ngjarjes, faqet 188-189.

**INDEKSI-2 Dokumentet e Prokurorisë (dosja 2)**

1. Memorandumi i PK-së-Raporti për veprimet hetimore operative-Rreshteri J.B. \_\_\_\_\_, faqet 306-308;
2. Raporti i politit-PK M.A. \_\_\_\_\_ # 5789, faqja 309;
3. Raporti i politit-PK S.V.2 \_\_\_\_\_ # 7150, faqja 310;
4. Raporti i politit – PK M.A. \_\_\_\_\_ # 5789, faqja 314.

**INDEKSI-3/1 (dokumentet e policisë):**

1. Raporti i TFM-së– në lidhje me ekzaminimin e vendit të ngjarjes, faqet 331-338;
2. Raporti për detajet e incidentit, faqet 339-340;
3. Raporti i TFM-së-Intervista e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqet 341-344;
4. Raporti i TFM-së – TFM AS # 1 dëshmitar, faqet 345-348;
5. Raporti i hetimit, faqet 363-365;
6. Vendndodhja e \_\_\_\_\_ në karvan, faqet 366-367;
7. Fotografitë e vendit të ngjarjes nga \_\_\_\_\_, faqet 390-391;
8. Raporti zyrtar –Hetuesi N.P. \_\_\_\_\_, faqja 392;
9. Raporti i TFM-së - në lidhje me ekzaminimin e vendit të ngjarjes, faqet 395-398;

10. Raporti i TFM-së-në lidhje me deklaratën e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqet 399 -418;
11. Intervista e \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_, faqet 419-430;
12. Rimarrja në pyetje e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqet 431-436;
13. Raporti i TFM-së – 6 albumet e të dyshuarve, faqet 437 -451;
14. Fotografia nga videoja publike e vendit të ngjarjes, faqet 452-506;
15. Raporti i TFM-së-fotoalbumi shtesë, faqet 511-515;
16. Foto albumi -15.08.2011, faqet 516-521;
17. Raporti përcjellës – raporti për raportin # 15 i datës 05.08.2011, faqet 526-537;
18. Raporti i TFM-së në lidhje me intervistën e dëshmitarit D.E. \_\_\_\_\_, faqet 538-549;
19. Raporti i NjRH-së për ekzaminimin e dy veturave që kanë qenë të përfshira në bllokimin e rrugës, faqet 550-555;
20. Fotografitë e “punëtorisë/mbeturinave të hekurit”, faqet 556-559;
21. Provat e konfiskuara, faqet 560-565;
22. Zbulimi i provave, faqet 566-577;
23. Raporti i TFM-së për marrëveshjen me dëshmitarin bashkëpunues M.1. \_\_\_\_për dorëzimin e dy veturave, faqet 588-593;
24. Kontrollimi në bazën e të dhënave të armëve për autorizimin për posedim të armëve të zjarrit nga ana e të dyshuarve për vrasjen e pjesëtarit të \_\_\_\_\_, faqet 588-593.

**INDEKSI-3/2 (dokumentet e policisë):**

1. Përbledhje e deklaratës së dëshmitarit M.D. \_\_\_\_\_, faqet 596-601;
2. Raporti i TFM-së-D. E. \_\_\_\_\_, faqet 602-609;
3. Raporti i TFM-së- Kërkimi i NIA-së —\_\_\_\_\_, faqet 628-633;
4. Fotografitë e automjetit të dëmtuar rëndë “\_\_\_\_\_”, faqet 643 -645;
5. Dokumentet e doganës, faqet 646-652;
6. Kopja e patentë shoferit të M.N. \_\_\_\_\_, faqet 653-654;
7. Raporti i TFM-së-Konfiskimi i automjetit të D.J. \_\_\_\_\_, faqet 661-666;
8. Eksponati nga Operacioni \_\_\_\_ – 08.09.2011, faqet 674-675;
9. Sigurimi i provave gjatë operacionit \_\_\_\_, faqet 681-682;
10. Raporti i bastisjes - Operacioni \_\_\_\_, faqet 683-684;
11. Raporti i TFM-së për hulumtimin e vendit të ngjarjes, faqet 687-688;
12. Raporti i NjHKO-së-bastisja e shtëpisë, faqet 698-704;
13. Fotografitë e sendeve të gjetura, faqet 705-707;
14. Përshkrimi i provave, faqet 708-709;
15. Raporti i NjHKO-së, bastisja e shtëpisë së M.V. \_\_\_\_\_, faqet 710-712;
16. Raporti i NjHKO-së, bastisja e shtëpisë së R.R. \_\_\_\_\_, faqet 721-723;
17. Përshkrimi i provave, faqet 724-725;
18. Harta me fotografi që i është bashkëngjitur raportit të bastisjes të lëshuar më datën 31.08.2011, faqet 726-733;
19. Raporti i TFM-së-zbulimi i provave nga vendi i ngjarjes, faqet 738-746;

20. Përgjigja në kërkesë e lëshuar nga \_\_\_\_\_ d.o.o, Beograd, me dokumentet e bashkëngjitura, faqet 765-784;
21. Raporti i TFM-së – rezultatet e fragmenteve të ekzaminimit të forenzikës, faqja 786;
22. Shtojca e raportit, lista e provave, faqet 787-795;
23. Raporti për ekspertizën e provave, faqet 796-799;
24. Raporti i PK F.G. \_\_\_\_\_, faqet 836-840.

#### INDEKSI-5 Forenzika/autopsia (dosja 5):

1. Raporti i ekspertizës nga Njësia e Armëve të Zjarrit, faqet 3413- 3432;
2. Lista e provave – zinxhiri i ruajtjes në rastin e vrasjes, Nr. i Forenzikës 11-092, faqet 3448-3460;
3. Raporti i ekzaminimit të vendit të ngjarjes, Nr. i Forenzikës 11-092 PK F.F. \_\_\_\_\_ # 5951, faqet 3461- 3473;
4. Raporti i ekspertizës nga Njësia e Armëve të Zjarrit, faqet 3476-3494;
5. Formulari i laboratorit të forenzikës A, D, C, B, vizita e TFM-së në vendin e ngjarjes, faqet 3495-3498;
6. Raporti i ekspertizës na Njësia për Traseologji dhe Daktiloskopi, faqet 3505-3507;
7. Raporti i forenzikës për fotoalbumin e fotografive, faqja 3512;
8. Raporti i mjekut për E.Z. \_\_\_\_\_ nga spitali i Mitrovicës, faqet 3516-3517;
9. Raporti i mjekut për E.Z. \_\_\_\_\_ nga spitali i Prishtinës, faqet 3518- 3522;
10. Certifikata e vdekjes me epikrizë, faqet 3523-3525;
11. Raporti i autopsisë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, faqet 3526-3527;
12. Vërtetimi i vdekjes, faqet 3528-3529;
13. Raporti i mjekësisë ligjore-raporti i autopsisë, faqet 3530-3535;
14. Fotoalbumi i autopsisë, faqet 3536-3591;
15. Lista e provave mjekoligjore/zinxhiri i ruajtjes. E. Z # 1A, E.z#1.1.A, faqet 3592-3594;
16. Fotoalbumi i rrobave zyrtare të zyrtarit E.Z. \_\_\_\_\_, faqet 3595-3604.

#### INDEKS, Ekzaminimi i automjetit (dosja 6)

1. Fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit me tabela të regjistrimit Police \_\_\_\_\_ - \_\_\_, Nr. i Forenzikës FRP-11 -140, faqet 994-999;
2. Automjeti Police \_\_\_\_\_ - \_\_\_, Nr. i Forenzikës FRP-11-140, raporti i ekzaminimit të automjetit, fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1000-1016;
3. Automjeti \_\_\_\_\_ - \_\_\_, Nr. i Forenzikës FRP-11-139, raporti i ekzaminimit të automjetit, fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1017- 1030;
4. Fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit me tabela të regjistrimit Police \_\_\_\_\_ - \_\_\_, Nr. i Forenzikës FRP-11-140, faqet 1031 -1035;
5. Automjeti \_\_\_\_\_ - \_\_\_, Nr. i Forenzikës 11-092, raporti i ekzaminimit të automjetit, lista e provave – zinxhiri i ruajtjes, fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1036- 1063;

6. Fotoalbumi i rrobave zyrtare të të ndjerit, fotografitë e zyrtarëve të lënduar, faqet 1064-1070, automjeti \_\_\_\_\_, Nr. i Forenzikës 11-088, raporti i ekzaminimit të automjetit lista e provave – zinxhiri i ruajtjes, faqet 1071-1076;
7. Automjeti \_\_\_\_\_, Nr. i Forenzikës 11-092, raporti i ekzaminimit të automjetit lista e provave – zinxhiri i ruajtjes fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1077 – 1089;
8. Fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1090-1113;
9. Automjeti \_\_\_\_\_ - Nr. i Forenzikës 11-088, lista e provave – zinxhiri i ruajtjes, raporti i ekzaminimit të automjetit, fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit, faqet 1115–1139;
10. Raporti informues për automjetet e têrhequra, faqet 1140-1141;
11. Raporti i ekzaminimit të automjetit, I.L.1. \_\_\_\_\_, faqja 1142;
12. Fotoalbumi i ekzaminimit të automjetit I.L.1. \_\_\_\_\_, faqja 1143;
13. Raporti i policit për veturën \_\_\_\_\_, faqja 1144;
14. Raporti i policit për 7 automjetet, faqja 1145;
15. Raporti i policit për 2 automjetet, faqja 1146;
16. Raporti i policit për municionin me të cilin është e pajisur \_\_\_, faqet 1147-1148;
17. Raporti i TFM-së, fotografia nga videoja publike e vendit të ngjarjes, faqet 1149 -1157;
18. Fotoalbumi me fotot e çastit që janë shpërndarë në ueb faqet publike, faqet 1158-1185;
19. Raporti i ekzaminimit të provave, nr. i rastit të forenzikës ITF 2011 012, faqet 1191 - 1196;
20. Raporti i TFM-së, rezultatet e analizës së kompjuterëve të J. \_\_\_\_\_ dhe V. \_\_\_\_\_, faqet 1197 – 1200;
21. Raporti informues, faqja 1204.

**INDEKSI i deklaratave të dëshmitarëve (Regjistratorët 9\_1 / 2/3):**

1. Deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqe 1762 -1811;
2. Deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqe 1819 -1818;
3. Deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, faqe 1838-1861;
4. Deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_, (PP P.K. \_\_\_\_\_), faqe 1862-1874;
5. Deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_ (PP N.A. \_\_\_\_\_), faqe 1875-1884;
6. Deklarata e dëshmitarit S.S. \_\_\_\_\_, faqe 1885-1897;
7. Deklarata e dëshmitarit N.S. \_\_\_\_\_, faqet 1898- 1909;
8. Deklarata e dëshmitarit B.M. \_\_\_\_\_, faqe 1910;
9. Deklarata e dëshmitarit D.P. \_\_\_\_\_, faqe 1929-1948;
10. Deklarata e dëshmitarit I.S. \_\_\_\_\_, faqe 1949-1961;
11. Deklarata e dëshmitarit I.I. \_\_\_\_\_, faqe 1962-1985;
12. Deklarata e dëshmitarit X.Z. \_\_\_\_\_, faqe 1986-2004;
13. Deklarata e dëshmitarit B.M.1. \_\_\_\_\_, faqe 2005-2019;
14. Deklarata e dëshmitarit P.M. \_\_\_\_\_, faqe 2020- 2037;
15. Deklarata e dëshmitarit E.A. \_\_\_\_\_, faqe 2038-2057;

16. Deklarata e dëshmitarit I.C. \_\_\_\_\_, faqet 2058- 2076;
17. Deklarata e dëshmitarit F.G.1. \_\_\_\_\_,faqet 2077- 2095;
18. Deklarata e dëshmitarit A.F. \_\_\_\_\_, faqe 2096-2114;
19. Deklarata e dëshmitarit V.M. \_\_\_\_\_, faqe 2115-2132;
20. Deklarata e dëshmitarit B.K. \_\_\_\_\_, faqe 2133-2149;
21. Deklarata e dëshmitarit I.L. \_\_\_\_\_, faqe 2150-2156;
22. Deklarata e dëshmitarit A.D. \_\_\_\_\_, faqe 2157-2175;
23. Deklarata e dëshmitarit G.K. \_\_\_\_\_, faqe 2176-2194;
24. Deklarata e dëshmitarit B.K.1. \_\_\_\_\_, faqe 2195-2213;
25. Deklarata e dëshmitarit F.R. \_\_\_\_\_, faqe 2214-2232;
26. Deklarata e dëshmitarit N.K. \_\_\_\_\_, faqe 2233-2249;
27. Deklarata e dëshmitarit B.A. \_\_\_\_\_, faqe 2250-2270;
28. Deklarata e dëshmitarit V.K. \_\_\_\_\_, faqe 2271-2291;
29. Deklarata e dëshmitarit I.J. \_\_\_\_\_, faqe 2292-2309;
30. Deklarata e dëshmitarit H.M. \_\_\_\_\_, faqe 2310-2328;
31. Deklarata e dëshmitarit L.H. \_\_\_\_\_, faqe 2329-2348;
32. Deklarata e dëshmitarit F.Z. \_\_\_\_\_, faqe 2349-2368;
33. Deklarata e dëshmitarit A.R. \_\_\_\_\_, faqe 2369-2390;
34. Deklarata e dëshmitarit M.J. \_\_\_\_\_, faqe 2391-2410;
35. Deklarata e dëshmitarit A.S. \_\_\_\_\_, faqe 2411-2430;
36. Deklarata e dëshmitarit N.S.1. \_\_\_\_\_, faqe 2432-2451;
37. Deklarata e dëshmitarit I.H. \_\_\_\_\_, faqe 2452-2471;
38. Deklarata e dëshmitarit L.Z. \_\_\_\_\_, faqe 2472-2490;
39. Deklarata e dëshmitarit N.K.1. \_\_\_\_\_, faqe 2491-2507;
40. Deklarata e dëshmitarit L.K. \_\_\_\_\_, faqe 2508-2526;
41. Deklarata e dëshmitarit S.H. \_\_\_\_\_, faqe 2527-2546;
42. Deklarata e dëshmitarit B.M.2. \_\_\_\_\_, faqe 2547-2563;
43. Deklarata e dëshmitarit F.S. \_\_\_\_\_, faqe 2564-2582;
44. Deklarata e dëshmitarit S.R. \_\_\_\_\_, faqe 2583-2601;
45. Deklarata e dëshmitarit Q.S. \_\_\_\_\_, faqe 2602-2621;
46. Deklarata e dëshmitarit R.Z. \_\_\_\_\_, faqe 2622-2641;
47. Deklarata e dëshmitarit B.B. \_\_\_\_\_, faqe 2642-2653;
48. Deklarata e dëshmitarit E.D. \_\_\_\_\_, faqe 2654-2674, faqe 2675-2698;
49. Deklarata e dëshmitarit B.M.3. \_\_\_\_\_, faqe 2699-2705;
50. Deklarata e dëshmitarit A.K. \_\_\_\_\_, faqe 2706-2721;
51. Deklarata e dëshmitarit I.N. \_\_\_\_\_, faqe 2722-2741;
52. Deklarata e dëshmitarit H.K.\_\_\_\_\_ , faqe 2742-2758;
53. Deklarata e dëshmitarit E.S. \_\_\_\_\_, faqe 2759-2764;
54. Deklarata e dëshmitarit F.M. \_\_\_\_\_, faqe 2765-2772;
55. Deklarata e dëshmitarit I.A. \_\_\_\_\_, faqe 2773-2780, faqe 2781-2806;

56. Deklarata e dëshmitarit G.C. \_\_\_\_\_, faqe 2807-2812;
57. Deklarata e dëshmitarit K.H. \_\_\_\_\_, faqe 2813-2820;
58. Deklarata e dëshmitarit B.P. \_\_\_\_\_, faqe 2821-2827;
59. Deklarata e dëshmitarit A.F.1. \_\_\_\_\_, faqe 2828-2845;
60. Deklarata e dëshmitarit P.L. \_\_\_\_\_, faqe 2846-2868;
61. Deklarata e dëshmitarit M.F. \_\_\_\_\_, faqe 2869-2876;
62. Deklarata e dëshmitarit A.B. \_\_\_\_\_, faqe 2877-2892;
63. Deklarata e dëshmitarit H.H. \_\_\_\_\_, faqe 2893-2898;
64. Deklarata e dëshmitarit M.S. \_\_\_\_\_, faqe 2899-2907;
65. Deklarata e dëshmitarit F.A. \_\_\_\_\_, faqe 2908-2913;
66. Deklarata e dëshmitarit M.D.1. \_\_\_\_\_, faqe 2914-2921;
67. Deklarata e dëshmitarit I.M. \_\_\_\_\_, faqe 2922-2936;
68. Deklarata e dëshmitarit R.H. \_\_\_\_\_, faqe 2937-2949;
69. Deklarata e dëshmitarit J.R. \_\_\_\_\_, faqe 2950-2967;
70. Deklarata e dëshmitarit S.K. \_\_\_\_\_, faqe 2968-2981;
71. Deklarata e dëshmitarit F.H. \_\_\_\_\_, faqe 2982-2994;
72. Deklarata e dëshmitarit V.R. \_\_\_\_\_, faqe 2995-3014;
73. Deklarata e dëshmitarit E.R. \_\_\_\_\_, faqe 3015-3033;
74. Deklarata e dëshmitarit B.R.1. \_\_\_\_\_, faqe 3034-3045;
75. Deklarata e dëshmitarit M.K.1. \_\_\_\_\_, faqe 3046-3058;
76. Deklarata e dëshmitarit B.M.2. \_\_\_\_\_, faqe 3059-3071;
77. Deklarata e dëshmitarit F.Q. \_\_\_\_\_, faqe 3072-3084;
78. Deklarata e dëshmitarit N.R. \_\_\_\_\_, faqe 3085-3096;
79. Deklarata e dëshmitarit F.B. \_\_\_\_\_, faqe 3097-3109;
80. Deklarata e dëshmitarit A.A. \_\_\_\_\_, faqe 3110-3122;
81. Deklarata e dëshmitarit B.M.4. \_\_\_\_\_, faqe 3123-3140;
82. Deklarata e dëshmitarit G.R. \_\_\_\_\_, faqe 3141-3159;
83. Deklarata e dëshmitarit A.I. \_\_\_\_\_, faqe 3160-3167;
84. Deklarata e dëshmitarit K.K. \_\_\_\_\_, faqe 3168-3174;
85. Deklarata e dëshmitarit M.I. \_\_\_\_\_, faqe 3175-3187;
86. Deklarata e dëshmitarit R.L. \_\_\_\_\_, faqe 3188-3200;
87. Deklarata e dëshmitarit S.G. \_\_\_\_\_, faqe 3201-3215;
88. Deklarata e dëshmitarit G.D. \_\_\_\_\_, faqe 3216-3220;
89. Deklarata e dëshmitarit A.H. \_\_\_\_\_, faqe 3221-3233;
90. Deklarata e dëshmitarit D.M. \_\_\_\_\_, faqe 3234-3246 dhe 3247-3252;
91. Deklarata e dëshmitarit M.H. \_\_\_\_\_, faqe 3253-3258;
92. Deklarata e të dyshuarit M.H. \_\_\_\_\_, faqe 3259-3286;
93. Verifikimi i deklaratës së dëshmitarit, faqe 3287-3313.

98. Raporti në lidhje me makinën e konfiskuar \_\_\_\_\_ me ngjyrë të errët blu dhe ekzaminimi forenzik, faqe 1640-1641;
99. Raporti i Forenzikës së bashku me fotografi, faqe 1643-1653;
100. Foto albumi, faqe 1654-1671;
101. Raporti mbi automjetin e dëmtuar (pa targa), faqe 1672-1675;
102. Lista e provave, faqe 1676;
103. Raporti i hetimit të vendit të ngjarjes, faqe 1677;
105. Procesverbal i intervistës së dëshmitarit - D.L. \_\_\_\_\_, faqe 1726-1728;
106. Raport informues i hetuesve, faqe 1730;
107. Raport informues i hetuesve, faqe 1739;
108. Hartë e vendndodhjes së \_\_\_\_\_, faqe 1758.

#### INDEKSI-12 Deklarata e të pandehurit

109. Intervista e të pandehurit M.V. \_\_\_\_\_ në procedurë paraprake, faqe 3314-3337;
110. Intervista e të pandehurit M.V. \_\_\_\_\_ në procedurë paraprake, faqe 3339-3350;
115. Intervista e të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ në procedurë paraprake (CD-ja me incizim video dhe audio të intervistës së të pandehurit R. \_\_\_\_\_ e datës 11 prill 2014), faqe 3384-3412.

#### INDEKSI Dokumentet shtesë - Raportet e policisë

115. \_\_\_\_\_ - përgjigje ndaj një kërkesë, faqe 14-17;
116. Raporti i TFM-së - Ndryshim në: Përbledhje e raportit të analizës, faqet 18-33;
117. Memorandum zyrtar i PK - Përgjigje ndaj kërkesës së Prokurorit të EULEX-IT - CD e bashkangjitur, faqe 34-35;
118. Raporti i zyrtarit të Pk S.V.2 \_\_\_\_\_ # 7150, faqe 36-39;
119. Raporti i TFM-së - Përbledhje e raportit të analizës, faqe 40-46;
120. Raporti i TFM-së - Përbledhje e raportit të analizës, faqe 47-54;
121. CD - regjistrimi i komunikimeve telefonike të \_\_\_\_\_.

Gjatë seancës së mbajtur më 17 tetor 2016 të pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ dhe të pandehurit M.V. \_\_\_\_\_ iu dha mundësia për tu deklaruar për rastin e tyre.

Mbrojtjet nuk kontestuan faktet e mëposhtme:

Më 26 korrik 2011, rrëth orës 13:30, më shumë se pesëdhjetë (50) zyrtarë të \_\_\_\_\_ së Kosovës (\_\_\_\_\_), pjesëtarë të Njësisë \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_), të cilët ishin në gatishmëri në bazën e \_\_\_\_\_ në Mitrovicë, që ndodhet në \_\_\_\_\_, morën urdhër që të nisen në drejtim të Portës \_\_\_\_\_ për të marrë nën kontroll pikës kufitare. Pra, autokolona i automjeteve të \_\_\_\_\_ u largua nga baza e \_\_\_\_\_. Autokolona e përbërë nga dy automjete të blinduara (njëri prej tyre ishte në krye të autokolonës dhe automjeti i dytë ishte në fund të autokolonës) dhe rrëth 10-12 automjete të \_\_\_\_\_ në mes të makinave të blinduara. Ndërsa ishin duke shkuar në drejtim të Portës \_\_\_\_\_ në rrugën kryesore të asfaltuar në mes të Mitrovicës dhe Zubin Potokut, në afërsi të

fshatit \_\_\_\_\_, autokolona e \_\_\_\_\_ hasi në barrikadën e parë të ngritur me gurë dhe rërë që penguan autokolonën që të vazhdojë më tej përgjatë rrugës kryesore. Prandaj, autokolona përdori një rrugë alternative dytësore për të kapërcyer barrikadën dhe pastaj u kthyen në rrugën kryesore në drejtim të Portës \_\_\_\_\_. Pasi që kishin vazhduar udhëtimin për një 10 minuta, në zonën që ndodhet në mes të fshatit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, autokolona e \_\_\_\_\_ hasi në një pengesë të dytë, këtë herë një barrikadë që përbëhej nga automjete të vendosura në mes të rrugës. Rreth tetë persona dolën nga automjetet dhe filluan të konfrontohen me \_\_\_\_\_ duke bërtitur, sharë dhe duke bërë gjeste në drejtim të \_\_\_\_\_. Pak çaste më vonë, edhe një automjet u afrua dhe u ndal në një distancë të caktuar nga barrikada. \_\_\_\_\_ I.S. \_\_\_\_\_ iu drejtua personave në këtë barrikadë në gjuhën \_\_\_\_\_ për të zhbllokuar rrugën. \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ urdhëroi personat të cilët ishin duke e bllokuar dhe penguar qarkullimin në autostradën publike që të largonin pengesat dhe të largonin makinat e tyre, në gjuhën \_\_\_\_\_. Këta persona nuk i janë bindur këtij urdhri dhe kanë vazhduar të cirren dhe t'i bërtasin \_\_\_\_\_, të bëjnë gjeste të ndryshme dhe të ngritin tre gishta dhe gishtin e mesëm në drejtim të \_\_\_\_\_. Në këtë moment, udhëheqësi i operacionit të \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ dha urdhër që automjeti i blinduar duhet të largojë automjetet e vendosura në barrikadë. Sapo automjeti i blinduar iu afrua automjeteve që kishin bllokuar rrugën, personat që ishin duke qëndruar pranë barrikadës u larguan dhe hynë në pyllin që ndodhej në anën e majtë. Sapo u larguan këta persona nga barrikada u dëgjuan të shtënët e para. Një plumb e kishte goditur E.Z. \_\_\_\_\_, pjesëtar i Njësisë \_\_\_\_\_, i cili po e ngiste veturën e dytë të autokolonës së \_\_\_, në fytyrë. Në momentin që ai ishte goditur, automjeti i tij ishte i pozicionuar në anën e majtë pas automjetit të blinduar në krye të autokolonës. Pas të shtënës së parë, që kishte goditur E.Z. \_\_\_\_\_, filluan të shtëna të menjëhershme kundër autokolonës së \_\_\_\_\_ nga tri drejtime të ndryshme. \_\_\_\_\_ u kundërpërgjigjen për tu mbrojtur. Në të njëjtën kohë, zyrtari i plagosur i \_\_\_\_\_ u zhvendos në automjet të blinduar. Të shtënët kundër autokolonës së \_\_\_ kanë zgjatur për një periudhë të pacaktuar kohe, jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) minuta, por me siguri derisa autokolona është tërhequr prapa dhe ka shkuar në drejtim të Mitrovicës. E.Z. \_\_\_\_\_ është sjellë në Qendrën Emergjente në Mitrovicë dhe më pas është dërguar me helikopter në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, ku edhe ka vdekur rreth orës 22:05, si pasojë e plagëve. Incidenti ndodhi në një pasdite verore me diell, ndërmjet orës 13:30 dhe 14:25, kur koha ishte e mirë me dukshmëri të mirë.

Faktet e paraqitura janë të konfirmuar nga deklaratat e dëshmitarëve që janë dëgjuar: F.U. \_\_\_\_\_, I.S. \_\_\_\_\_, N.S. \_\_\_\_\_, S.S. \_\_\_\_\_, E.D. \_\_\_\_\_, V.K. \_\_\_\_\_, F.Z. \_\_\_\_\_, M.J. \_\_\_\_\_, F.F. \_\_\_\_\_, I.L. \_\_\_\_\_, B.M. \_\_\_\_\_, B.P. \_\_\_\_\_, K.H. \_\_\_\_\_, M.S. \_\_\_\_\_, F.A. \_\_\_\_\_, G.C. \_\_\_\_\_, H.H. \_\_\_\_\_, K.K. \_\_\_\_\_, A.I. \_\_\_\_\_, G.D. \_\_\_\_\_ dhe V.R. \_\_\_\_\_.

Gjatë procedurës së shqyrimit kryesor, mbrojtjet e të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe të pandehurit **M.V.** \_\_\_\_\_ mohuan faktin se **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe **M.V.** \_\_\_\_\_

ishin tek barrikada në momentin kritik dhe të kenë kryer ndonjë nga veprat penale për të cilat akuzohen.

Dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ ka deklaruar se më 26 korrik 2011 si \_\_\_\_\_ Kosovës, ai ishte duke udhëtuar me një automjet të blinduar, i cili ishte automjeti i parë në autokolonën e \_\_\_\_\_ që po udhëtonte në drejtim të Portës \_\_\_\_\_. Drejtuesi i këtij automjeti ishte E.D. \_\_\_\_\_. I.S. \_\_\_\_\_ ishte i ulur në vendin e bashkudhëtarit. Në anën e pasme, me të, ishin N.S. \_\_\_\_\_, S.S. \_\_\_\_\_. Së pari, ai ishte në anën e majtë në ulësen e pasme, por gjatë udhëtimit, në barrikadën e parë në fshatin \_\_\_\_\_, ai ndërroi vendin nga ana e majtë në anën e djathtë, për t'iu treguar kolegëve të tij rrugët alternative pasi që e njeh atë zonë pasi që \_\_\_\_\_ atje. Kur ata hasën në barrikadën e dytë me automjete, ai u zhvendos nga ana e djathtë në mes, në mes të ulëses së shoferit dhe bashkudhëtarit për t'i drejtuar gjatë udhëtimit. Ai ka parë pesë automjete që kanë ardhur aty dhe kanë bllokuar rrugën. Këta njerëz kanë dalë nga automjetet, dhe, në forma të ndryshme, me gjeste, kanë fyer \_\_\_\_\_ dhe kanë kundërshtuar praninë e tyre dhe kalimin e tyre nëpër atë rrugë. Ai i ka parë ata nga pozita në mes të shoferit dhe bashkudhëtarit. Këta njerëz iu tregonin gishtin e mesëm dhe ngrinin tre gishta the \_\_\_\_\_. Kjo ishte fyeze për \_\_\_\_\_, sepse ngritja e tre gishtave është simbol \_\_\_\_\_. Distanca e përafërt në mes të automjetit të blinduar dhe automjeteve që kishin ndaluar para autokolonës ishte rreth 15-20 metra. Ai ka parë gjithsej 10-15 njerëz. Disa prej tyre ishin para automjeteve, por, më pas, edhe ata shkuan prapa automjeteve të ndaluara në rrugë. Prej këtyre 10-15 personave, dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ ka njojur katër prej tyre, me emër ose me pseudonimet e tyre. Ai ka njojur **R.R.** \_\_\_\_\_, por në lidhje me të, ai ishte në konfuzion në lidhje me mbiemrin e tij, pasi që ai nuk ishte i sigurt nëse mbiemri i tij ishte **R. \_\_\_\_\_, R.1. \_\_\_, ose R.2. \_\_\_\_\_. Kur dëshmitarit i është treguar foto albumi, ai ka parë aty foton e **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe e ka identifikuar atë si pjesëmarrës në turmën që ka dalë nga automjetet, të cilat ishin të vendosura në barrikadën përballë \_\_\_\_\_. Ai deklaroi se së pari ka njojur **R.R.** \_\_\_\_\_ nga foto albumi, edhe pse nuk e dinte mbiemrin e tij në atë kohë. Pastaj ai mësoi mbiemrin e tij nga mediat. Dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ më tej shpjegoi se ai e njihte **R.R.** \_\_\_\_\_ nga pamja për 20-25 vjet. Ata e njojin njëri-tjetrin pasi që \_\_\_\_\_ e tyre janë pranë njëri-tjetrit. Për më tepër, një javë apo dhjetë ditë para këtij incidenti, dëshmitari, së bashku me të ndjerin E.Z. \_\_\_\_\_, kishin ndaluar **R.R.** \_\_\_\_\_ në një pikë kontrolli të rregullt. **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte në një \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_, me targa të \_\_\_\_\_. Në atë kohë **R. \_\_\_\_\_. nuk ka pasur asnjë dokument identifikimi, përveç gjobave të lëshuara nga policia. F.U. \_\_\_\_\_ gjithashtu deklaroi se ai u takua dhe njoju **R.R.** \_\_\_\_\_ në hyrje të Gjykatës dhe deklaroi se ai është i njëjti person, i cili ishte ulur në fillim, në rreshtin e parë në gjykatore gjatë gjykimit.****

Dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ identifikoi edhe të pandehurin **M.V.** \_\_\_\_\_, si një person i cili ishte i pranishëm në barrikadën e dytë në kohën kur autokolona e \_\_\_\_\_ u ndal aty. Gjatë procedurës paraprake, dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_ iu tregua Foto albumi dhe ai identifikoi të pandehurin **M.V.** \_\_\_\_\_. Dëshmitari ishte i sigurt se njeriu i paraqitur në

fotografinë nr.1 të Foto albumit nr. 4 ishte njëri nga personat që i kujtohej atij nga barrikada për shkak se ai ishte veçanërisht aktiv për sa u përket britmave dhe bërjes së gjesteve kundër autokolonës së \_\_\_\_\_. Në lidhje me dy individët që ai njoihu në Foto albume, ku njëri prej tyre ishte M.V. \_\_\_\_\_, dëshmitari ka theksuar se, pasi që ai nuk i kishte parë ose takuar këta persona më pare, ai u fokusua veçanërisht tek ata, në mënyrë që të jetë në gjendje t'i njoh ata në të ardhmen. Lidhur me pretendimet e Mbrojtjes së M.V. \_\_\_\_\_ se fotot e të gjithë të pandehurve në lidhje me incidentin në fjalë janë vendosur nën numrin 1 në Foto albumet e përdorur për identifikim, dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ u përgjigj se nuk kishte asnjë shans që dikush të mund të ndikonte tek ai për të identifikuar njerëz të caktuar. Ai theksoi se si \_\_\_\_\_ së Kosovës, me rastin e marjes së urdhrit të paligjshëm, është e drejtë dhe obligim i tij për ta denoncuar atë. Gjithashtu është puna e personit i cili ka paraqitur foto rreshtimin, për të shënuar fotot me numra, dhe puna e tij ishte vetëm t'i identifikojë ata. Ai mohoi çdo ndikim në të gjatë procedurës së identifikimit gjatë së cilës ai njoihu M.V. \_\_\_\_\_ si një person që ishte në barrikadën e dytë.

Dëshmitari I.S. \_\_\_\_\_ dëshmoi se, në ditën përkatëse, në rrugën për tek Porta \_\_\_, ai ishte në automjet të blinduar së bashku me E.D. \_\_\_\_\_, F.U. \_\_\_\_\_, N.S. \_\_\_\_\_ dhe S.S. \_\_\_\_\_. E.D. \_\_\_\_\_ ishte drejtues i makinës dhe I.S. \_\_\_\_\_ ishte ulur në ulësen e bashkudhëtarit. Ata kanë hasur në barrikadën prej katër automjeteve dhe më vonë arriti edhe një automjet tjeter. Automjetet kishin bllokuar rrugën dhe këta persona dolën nga automjetet. Pasi që autokolona hasi në barrikadë, kolegu i tij F.U. \_\_\_\_\_ iu afroa atij, në të vërtetë, ai u përkul përpara në hapësirën në mes të I.S. \_\_\_\_\_ dhe vendit të shoferit duke u afroar drejt xhamit të përparmë për të parë më për së afërmi personat në barrikadë. Dëshmitari deklaroi se F.U. \_\_\_, duke shikuar personat që dolën nga automjetet ka thënë: “Unë i njoh disa prej këtyre personave.”. Duke qenë se F.U. \_\_\_\_\_ në këtë zonë, më saktësisht ai është nga \_\_\_\_\_, ai njoihu disa nga personat në barrikadë. I.S. \_\_\_\_\_ theksoi se ai i tha F.U. \_\_\_\_: “Pasi që i njeh ata, shikoj mirë ata”. Ai gjithashtu theksoi se kishte 7-8 persona në barrikadë, dhe të dy, F.U. \_\_\_\_\_ dhe kishin pamje të qartë. Hapësira në mes të ulëseve të para ishte një hapësirë mjaft e madhe, kështu që pamja ishte e qartë dhe F.U. \_\_\_\_\_ kishte pamje të mirë prej aty, pavarësisht nga fakti se në xhamin e përparmë ishin të vendosura disa shufra hekuri. Automjeti kishte pamje të mjaftueshme dhe ata mund të shihnin gjithë rrugën dhe njerëzit në barrikadë. I.S. \_\_\_\_\_ nuk e kuption gjuhën \_\_\_\_\_, por ai e kuptoi se njerëzit në barrikadë ishin duke sharë, duke fyer dhe duke bërtitur dhe duke bërë gjeste të ndryshme me duar. Në një moment, ai e hapi derën e automjetit të blinduar dhe pastaj qëndroi tek dera e automjetit duke iu thënë atyre, në gjuhën \_\_\_\_\_, që të lironë rrugën. Në atë moment, erdh edhe \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ me automjetin e tij dhe u ndal paralelisht me automjetin e tij. I.A. \_\_\_\_\_ I urdhër këta njerëz në gjuhën \_\_\_\_\_ që të lironë rrugën. Duke qenë se njerëzit në barrikada nuk e liruan rrugën, ai urdhëroi \_\_\_\_\_ për të vazhduar dhe për të hapur rrugën me automjet të blinduar. Dëshmitari I.S. \_\_\_\_\_ hyri në automjetin e blinduar dhe njoftoi shoferin se kishin urdhër për të vazhduar dhe për të liruar rrugën me automjet të blinduar. Pra, ata i larguan këto automjete nga rruga. Derisa ata ishin duke

e liruar rrugën, filluan të shtëna dhe pastaj janë dëgjuar vazhdimisht të shtëna me armë zjarri. Një lloj gazi u shfaq në automjetin e tyre. Ndoshëta automjeti u godit nga plumbat ose diçka të tillë, deklaroi ai. Ishte si gaz lotsjellës. Ata shkuan me automjetin tonë të blinduar pranë automjetit të E.Z. \_\_\_\_\_, që ishte pas tyre. Pastaj, kolegët e tyre filluan të bërtasin: "U qëllua \_\_\_\_\_", përkatësisht, se \_\_\_\_\_ ishte i plagosur. Prandaj, ata erdhën pranë automjetit ku ishte E.Z. \_\_\_\_\_, zyrtarët e ulur në ndenjëset e pasme hapën derën, kapën E.Z. \_\_\_\_\_ dhe e tërroqën atë në automjetin e blinduar. Duke qenë se ata kishin \_\_\_\_\_ të plagosur, ata u detyruan të kthehen për t'i dhënë atij trajtimin mjekësor. E.Z. \_\_\_\_\_ është transportuar me automjet të blinduar në qendrën shëndetësore në Mitrovicë dhe më pas në Prishtinë, ku ai ka vdekur. \_\_\_\_\_ nuk ka arritur tek Porta \_\_\_, sepse ata ishin ndalur aty nga barrikada dhe janë detyruar të tërhiqen prapa.

Dëshmitari N.S. \_\_\_\_\_ deklaroi se, në rastin në fjalë, ai ishte në automjetin e blinduar së bashku me I.S. \_\_\_\_\_, S.S. \_\_\_\_\_, F.U. \_\_\_\_\_ dhe një shofer nga Prishtina emrin e të cilit nuk e dinte. Gjatë udhëtimit ai ishte ulur në pjesën e pasme të automjetit. Ai e përshkroi pjesën e përparme të automjetit, ku ishin dy ndenjëse: ulësja e shoferit dhe ulësja e bashkudhëtarit. Në pjesën e pasme të automjetit ishin dy vende të ndara, më shumë si stola, njëri në të djathëtë dhe tjetri në anën e majtë të automjetit. F.U. \_\_\_\_\_ fillimisht ishte ulur prapa shoferit, por gjatë vozitjes ai e ndryshoi vendin e tij. Së pari, kur ata hasën në barrikadën e pare, ai u ul prapa bashkudhëtarit për t'i treguar shoferit rrugën alternative. Pastaj ai u vendos në mes të ulëseve të para dhe kontakttoi me shoferin E.D. \_\_\_\_\_ dhe I.S. \_\_\_\_\_. Dëshmitarit i kujtohen katër-pesë automjete të cilat bllokuan rrugën dhe ngritën barrikadën e dytë. Në këtë moment autokolona e \_\_\_\_\_ hasi në barrikadën e dytë, telefonat celularë dhe radiot nuk ishin funksionale. Kishte rreth 7-8 njerëz në barrikadë. Ai nuk i njohu ata, por F.U. \_\_\_\_\_ i njohu ata. N.S. \_\_\_\_\_ dëshmoi gjithashtu se, në atë moment, F.U. \_\_\_\_\_, në lidhje me njerëzit në barrikadë tha: "Unë i njoh ata!" Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se I.S. \_\_\_\_\_ pastaj i tha U. \_\_\_\_\_: "Pasi që ti i njeh ata, eja afër me dhe vëzhgoj ata." Dhe, F.U. \_\_\_\_\_ u ngrit dhe u përkul përpara për të parë këta persona. Ai ishte afër xhamit të përparmë. Dukshmëria ishte e mjaftueshme edhe pse xhami i përparmë ishte i ndarë në dy pjesë. N.S. \_\_\_\_\_ vlerësoi se distanca në mes të automjetit të tyre dhe personave në barrikadë ishte 15-30 m. Pas marrjes së urdhrit për heqjen e barrikadave me automjet të blinduar, ata filluan largimin e makinave nga rruga. Personat që ishin në barrikadë ikën në një pyll dhe të shtënat kundër autokolonës filluan. Zyrtari E.Z. \_\_\_\_\_ u qëllua dhe autokolona ishte e detyruar të tërhiqet prapa.

Dëshmitari S.S. \_\_\_\_\_ dëshmoi se, në ditën kritike, si \_\_\_\_\_, ai ishte në automjet të blinduar me E.D. \_\_\_\_\_, I.S. \_\_\_\_\_, F.U. \_\_\_\_\_, dhe N.S. \_\_\_\_\_. Rrugës për tek Porta \_\_\_, ata hasën në dy barrikada. E dyta ishte bërë me 4 ose 5 automjete të vëna në rrugë duke e bllokuar atë para autokolonës të \_\_\_\_\_. Barrikada që ishte bërë me automjete ishte 10-15, jo më shumë se 20, metra larg nga autokolona. Kjo është arsyaja pse ndaloj autokolona e \_\_\_\_\_. Sipas asaj që i kujtohet atij, kishte 4, 5 ose 6 persona në barrikadë dhe ata shanin me fjalë të

ndryshme të pista. "Ata shanë aq sa patën mundësi. ", deklaroi dëshmitari. \_\_\_\_\_ I.S. \_\_\_\_\_ u bërtiti këtyre njerëzve: "Ndaloni \_\_\_\_\_!" dhe ai bërtiti kështu disa herë pa dobi. Ata e thirrën komandën dhe iu treguan atyre për situatën e krijuar, por komanda urdhëroi autokolonën e \_\_\_\_\_ që të vazhdojë më tej. Dëshmitari S.S. \_\_\_\_\_ deklaroi se I.S. \_\_\_\_\_ bisedoi me komandën, por ai bisedoi gjithashtu me F.U. \_\_\_\_\_, i cili është nga ky \_\_\_\_\_. Ai i sugjeroi F.U. \_\_\_\_\_ që të afrohet më pranë tij për të parë më qartë nëse i njihet njerëzit që ishin në barrikadë, gjë që ai e bëri. Ai gjithashtu deklaroi se ata të gjithë (\_\_\_\_\_) nga ai automjet, faktikisht panë personat të cilët erdhën me makina, bllokuan rrugën dhe dolën prej atyre makinave, por të gjithë ata nuk i njihnin këta njerëz, vetëm F.U. \_\_\_\_\_ i njihet.

Dëshmitari E.D. \_\_\_\_\_ deklaroi se ai ishte drejtuesi i automjetit të parë, atij të blinduar. Atje, në automjetin e blinduar, ishin kolegët e tij, emrat e të cilëve nuk i kujtohen. Por, atij i kujtohej se disa prej tyre ishin nga rajoni i \_\_\_\_\_. Ndërsa ata ishin në rrugë për tek Porta \_\_\_\_\_ në ditën në fjalë, ata hasën në katër automjete që bllokuan rrugën dhe paraqitnin pengesë. Prandaj, ai ndaloi automjetin e blinduar dhe iu drejtua kolegëve të tij për të marrë udhëzime të mëtejshme. Kur ata u përpoqën të lidhen me radio, ishte një "vend pa qasje në rrjet", nuk kishte lidhje me radio apo me telefon. Personat që dolën nga automjeti qëndroi para automjeteve të \_\_\_\_\_, përballë makinës së blinduar. Kolegu i tij nga \_\_\_\_\_ përmendi personat që ai i njihet. Dëshmitari E.D. \_\_\_\_\_ pohon se njëri nga kolegët e tij i njihet ata. Me atë rast, kolegi i emëruar ishte duke diskutuar këtë me një koleg tjetër nga \_\_\_\_\_ nga pjesa e pasme. Personi, nga makina e parë që arriti atje, (\_\_\_\_\_), mori nga makina, erdhën para të automjetit të \_\_\_\_\_, dhe e bëri gjeste që tregojnë të \_\_\_\_\_ të kthehet mbrapa si ishte bllokuar rruga. Njeriu, i cili iu bënte atyre me dorë për ti kthyer prapa, ishte i gjatë, me gjatësi 185-190 centimetra dhe sa mund të shihte ai nga automjeti, ai kishte flokë të zezë të shkurtra. Dëshmitarit i kujtohet personi tjetër, me kokë me formë të rrumbullakët, i cili gjithashtu ka qëndruar në afërsi të automjetit dhe nuk ka lëvizur. Dy persona të tjera nga dy makina të tjera u larguan apo dolën nga makinat. Dëshmitari tha gjithashtu se ai nuk iu kushto shumë vëmendje njerëzve pasi që ishte i përqendruar për të hapur rrugën. Ai mori një urdhër të tillë dhe, ndërsa ai do të godiste makinat në rrugë me automjet të blinduar për të hapur rrugën, njerëzit në barrikadë e kuptuan qëllimin e tij dhe u shpërndanë. Ata u larguan nga rruga dhe hynë në pyll. Që nga ai moment e tutje filluan të shtënat. I pyetur se sa dritare kishte automjeti që ai drejtonte, dëshmitari u përgjigj se automjeti kishte xham të dyfishtë të përparmë të ndarë në mes me ndarje metalike.

Dëshmitari I.A. \_\_\_\_\_ ka deklaruar se gjatë rastit kritik, ai ishte në një automjet \_\_\_\_\_ që nuk ishte i blinduar, i cili ishte automjeti i tretë në autokolonën e \_\_\_\_\_. Automjeti kryesor ishte i blinduar dhe automjeti i dytë ishte automjeti i të ndjerit E.Z. \_\_\_\_\_. Kur ata arritën te barrikada e dytë, automjeti i I.A. \_\_\_\_\_ u ndal në anën e djathtë të rrugës, ndërsa automjeti i blinduar ishte pak më i avancuar përpara. Automjeti tjetër \_\_\_\_\_ që nuk ishte i blinduar i kolegut të ndjerë të tyre Z. \_\_\_\_\_ u ndal në anën e majtë, pas automjetit të

blinduar. Dëshmitari ishte në automjet me tre kolegët e tij: F. \_\_\_\_\_, I. \_\_\_\_\_ dhe M. \_\_\_\_\_. Dëshmitari pa tre persona duke ndaluar makinat e tyre në rrugë duke e bllokuar atë dhe që pastaj shkuan prapa makinave. Ai gjithashtu pa 3 - 4 persona të tjerë që qëndronin pak më larg nga ajo barrikadë. Personat që pa dëshmitari i përshkroi si "me qëndrim pak a shumë agresiv". Ai ishte në gjendje ta shihte këtë. Ai iu foli atyre në gjuhën \_\_\_\_\_ duke u thënë atyre të lironin rrugën. Ai gjithashtu prezantoi veten e tij dhe kolegët e tij si \_\_\_\_\_. Por njerëzit në barrikadë u përgjigjën duke thënë se \_\_\_\_\_ nuk mund të vinte në atë anë, pasi që ajo ishte Serbi. Më pas, dëshmitari urdhëroi automjetin e blinduar të thyejë barrikadën dhe pastaj përsëri të tërhiqen në pikën fillestare. Pas këtij veprimi, këta persona, të cilët ishin në barrikadë, ikën në pyll, pasi që pylli ishte afër. Pastaj u dëgjua një e shtënë me armë zjarri. Pas kësaj, ata dëgjuan nga \_\_\_\_\_ tjetër i \_\_\_\_\_ se një \_\_\_\_\_ ishte plagosur. Pastaj filluan të shtëna më intensive, si nga ana e kundërt ashtu edhe nga ana e tyre. Kjo zgjati për rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë minuta më së shumti. Dëshmitari deklaroi se, nga anëtarë të tjerë të \_\_\_\_\_ eshtë thënë se, në atë vend, ka pasur \_\_\_\_\_ të Kosovës të cilët kishin mundur të njohin personat në barrikadë, por dëshmitari nuk i njihet ata. I pyetur nëse ai i ka parë të pandehurit në barrikadë, dëshmitari u përgjigj se ata përshtaten me personat që ai ka parë, por ai mund të ketë qenë i sigurt.

Dëshmia e dëshmitarit D.P. \_\_\_\_\_ dhe deklaratat e dëshmitarëve V.K. \_\_\_\_\_, F.Z. \_\_\_\_\_, M.J. \_\_\_\_\_, F.F. \_\_\_\_\_, I.L. \_\_\_\_\_, B.M. \_\_\_\_\_ B.P. \_\_\_\_\_, K.H. \_\_\_\_\_, M.S. \_\_\_\_\_, F.A. \_\_\_\_\_, G.C. \_\_\_\_\_, H.H. \_\_\_\_\_, K.K. \_\_\_\_\_, A.I. \_\_\_\_\_, G.D. \_\_\_\_\_ dhe V.R. \_\_\_\_\_, të cilat janë lexuar gjatë shqyrtimit kryesor, janë identike në lidhje me rrethanat esenciale. Ata të gjithë deklaruan se ishin në autokolonën e \_\_\_\_\_ si zyrtarë të cilët ishin urdhëruar të shkojnë tek Porta \_\_\_. Ata, gjithashtu dëshmuan se autokolona ishte e detyruar të ndalojë për shkak të barrikadës së makinave që ishte vendosur në rrugë në afërsi të \_\_\_\_\_. Ata përshkruan se të shtënat kundër tyre filluan dhe njëri prej \_\_\_\_\_ u qëllua, kështu që autokolona u detyrua të tërhiqet pa arritur tek Porta \_\_\_. Ata nuk e dinë ndonjë detaj të veçantë në lidhje me personat në barrikadë, pasi që ata ishin në automjetet e \_\_\_\_\_ që ishin ndalur në një distancë më të largët nga barrikada dhe ata nuk ishin në pozita për të parë qartë njerëzit në barrikadë.

Dëshmitari B dëshmoi se më 26 korrik 2011 ai/ajo ishte duke shkuar nga \_\_\_\_\_ në drejtim të \_\_\_\_\_. Barrikada ishte përpëra tij/saj. Gjatë rrugës, në zonën e fshatit \_\_\_\_\_, ai/ajo ka parë të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, rreth 200 deri 300 metra larg barrikadës së ngritur me makina. R.R. \_\_\_\_\_ ishte përskaj rrugës, 5-10 metra nga dëshmitari. Dëshmitari e di se pseudonimi i R.R. \_\_\_\_\_ eshtë "\_\_\_\_\_. Në atë kohë, R. \_\_\_\_\_ ishte me S.V. \_\_\_\_\_. Atje ishin rreth 10 persona, por dëshmitari njoju vetëm R. \_\_\_\_\_ dhe V. \_\_\_\_\_ në mesin e tyre. Në të njëjtën kohë, dëshmitari dëgjoi të shtëna, përkatësisht disa breshëri armësh. Nga vendi nga i cili dëshmitari e pa të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, ai/ajo ende nuk mund të shihte barrikadën. Dëshmitari tha gjithashtu se të gjitha barrikadat janë organizuar nga autoritetet në

\_\_\_\_\_, Kryetari i \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Barrikadat ishin diçka që ndodhte mjaft shpesh në atë kohë. Ai/ajo shpjegoi se, kur e kërkonte situata, kryetari i \_\_\_\_\_ alarmonte njerëzit dhe njerëzit shkonin atje ku ju thuhej të shkonin. Njerëzit paralajmëroheshin me sirenë në \_\_\_\_\_. Kur e dëgjonin sirenën ata mblidheshin. Dhe kjo është pikërisht ajo që ndodhi në ditën në fjalë. Ai/ajo deklaroi se kjo ngjarje ishte e organizuar dhe zhurma e sirenës do të thoshte se duhej shkuar atje në barrikada. Dëshmitari B gjithashtu ka dekluar se ai/ajo ka parë shpërndarjen e armëve dhe municionit në \_\_\_\_\_ (të tipit AK-47) dhe disa persona, të cilët ishin në afërsi të magazinës në fshatin \_\_\_\_\_, kishte armë. Dëshmitari shënoi magazinën në fshatin \_\_\_\_\_ si pikën B në skemë, ndërsa ai/ajo shënoi barrikadën si pika A.

Mbrojtja e R.R. \_\_\_\_\_ paraqiti shtatë dëshmitarë për alibi: S.V. \_\_\_\_\_, Z.J. \_\_\_\_\_, Z.M. \_\_\_\_\_, S.V.I. \_\_\_\_\_, M.K. \_\_\_\_\_, Z.D. \_\_\_\_\_ dhe D.D. \_\_\_\_\_.

Dëshmitari S.V. \_\_\_\_\_ ka dekluar se, në ditën kritike, nga rrëth orës 10:45 orës, ai ishte me R.R. \_\_\_\_\_. Ata ishin së bashku në kafe “\_\_\_\_\_”, në \_\_\_\_\_, dhe pastaj ata shkuan në kafenenë “\_\_\_\_\_. Ai gjithashtu përmendi se, në një moment, S.J. \_\_\_\_\_ ishte me ta. Nga \_\_\_\_\_ ata shkuan në drejtim të \_\_\_\_\_. Ndërsa ata ishin ende në \_\_\_\_\_, filluan të shtënat. Në rrugë për në \_\_\_\_\_, ata u ndalën pranë magazinës në fshatin \_\_\_\_\_, që ndodhet në mes të \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_. Depoja është në pronësi të vëllait të S.V. \_\_\_\_\_, S. \_\_\_. R.R. \_\_\_\_\_ parkoi makinën e tij, \_\_\_\_\_, me targa të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_, para kafenesë \_\_\_\_\_, ngjitur me objektin e depos. Kur arritën në depo, ata panë rrëth 100 njerëz duke u strehuar atje, duke u përpjekur të fshihen nga të shtënat që po vazhdonin. S.V. \_\_\_\_\_ deklaroi se R.R. \_\_\_\_\_ ishte shok i tij, si dhe babai i R. \_\_\_. Ai gjithashtu përmendi se R.R. \_\_\_\_\_ ishte një atlet.

Dëshmitari Z.J. \_\_\_\_\_ tha se ditën kritike ai e pa R.R. \_\_\_\_\_ në kafenenë "\_\_\_\_\_. Kjo ishte rrëth orës 10-12:00. R.R. \_\_\_\_\_ ishte me S.V. \_\_\_\_\_ duke pirë një kafe në kafene, dhe dëshmitari ishte ulur në një tavolinë tjetër në kafene me gruan e tij. Derisa ishin aty, një sirenë u aktivizua. Njerëzit filluan të lëvizin, dhe ata u ngritën nga tavolina e tyre dhe filluan të lëvizin në kahjet kah ishin duke lëvizur njerëzit. Kur ata arritën te pika e karburantit dhe një urë e vogël në \_\_\_\_\_, dëshmitari pa shumë njerëz të mbledhur atje. Ai e pa R.R. \_\_\_\_\_ qw kishte parkuar veturën e tij në oikën e karburantit dhe dëshmitari gjithashtu e parkoi veturën e tij aty, dhe vazhduan të ecin në këmbë nga aty. Ata mundën të dëgjojnë nga njerëzit: "Të shkojmë në \_\_\_\_\_!", dhe shumë automjete tashmë ishin duke kaluar pranë. Ata vendosën të kthehen te veturat e tyre, dëshmitari hyri në veturën e tij, dhe R.R. \_\_\_\_\_ me S.V. \_\_\_\_\_ hynë në veturën \_\_\_\_\_ me \_\_\_\_\_ të R. \_\_\_\_\_. Vetura e R. \_\_\_\_\_ ishte përpara veturës së dëshmitarit". Ata arritën në fshatin \_\_\_\_\_ dhe dëshmitari arriti te një depo nga ku ai pa një turmë të njerëzve në panik duke vrapiuar duke u përpjekur për t'u thënë atyre të ndalonin për shkak se diçka po ndodhte. R.R. \_\_\_\_\_ parkoi veturën e tij para

godinës që, në atë kohë, ishte "restoranti \_\_\_\_\_", dhe Z.K. \_\_\_\_\_ parkoi menjëherë pas tij. Në momentin kur ai e fiku veturnën e tij, dëshmitari mundi të dëgjojë të shtëna. Së pari, ata shkuan prapa restorantit, por më vonë ata vendosën të lëvizin brenda kompleksit të depos sepse ishte më sigurt për ta. Ky dëshmitar po ashtu përmendi se ai e pa "personin D. \_\_\_\_\_" në depo duke blerë material ndërtimor për shtëpi. Sapo dëshmitari vendosi të largohet nga depo, ai i pa R. \_\_\_\_\_ and V. \_\_\_\_\_ atje pranë shtyllës elektrike e cila ishte në anën e kundërt të depos, përtej rrugës rajonale.

Dëshmitari Z.M. \_\_\_\_\_ ka dekluaruar se ai e njeh R.R. \_\_\_\_\_ qe disa vite. Në ditën kritike, pasi ai u zgjua rreth orës 12:00-12:30, ai hipi në veturnën e tij dhe u nis drejt \_\_\_\_\_ nga kureshtja. Ai më tej shtoi se sirena, të cilën ai fare nuk e ka dëgjuar atë ditë, por e kishte dëgjuar gruaja e tij, shkaktoi një lloj kureshtje, ndoshta panik dhe frikë në mesin e të gjithë qytetarëve, dhe ata u mblohdhën në \_\_\_\_\_. Dikush nga grupi i këtyre njerëzve bërtiste me zë të lartë se diçka po ndodhët në \_\_\_\_\_ dhe se të gjithë duhet të shkojnë në atë drejtim. Por dëshmitari iu shmang përgjigjes se pse ai shkoi pikërisht në atë vend në \_\_\_\_\_, pasi është dëgjuar sirena duke thënë se ai nuk ishte në gjendje të ofrojë ndonjë arsyë të mjaftueshme për këtë në momentin që ai ishte duke dhënë dëshminë. Pasi ai arriti te depoja në fshatin \_\_\_\_\_, dhe derisa ai ishte ende në veturnën e tij, ai dëgjoi të shtëna. Ai gjithashtu i ka parë njerëzit duke vrapuar nga depoja dhe nga ana e majtë e rrugës në drejtim të \_\_\_\_\_. Ai e ka parë të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, duke qëndruar në rrugë pranë depos. Ai theksoi se gjithashtu e pa edhe S.V.1. \_\_\_\_\_ brenda depos. Ai gjithashtu deklaroi se, në atë kohë ai ishte punonjës i Ministrisë së \_\_\_\_\_ të Republikës së \_\_\_\_\_, por që nga viti 2014 ai është pjesëtar i \_\_\_\_\_.

Dëshmitari S.V.1. \_\_\_\_\_ është drejtor i depos që gjendet në fshatin \_\_\_\_\_. Më 26 korrik 2011, para se ai të dëgjonte të shtënat, ai ishte në depo me D.D. \_\_\_\_\_ i cili kishte ardhur aty për të blerë disa materiale elektrike. Ndërsa ata ishin duke pirë nga një kafe, filluan të shtënat, ndërsa ata dëgjuan të shtënat nga drejtimi i \_\_\_\_\_. Kur filluan të shtënat, ata të dy shkuan në pjesën kuti të depos ku është mbajtur rërë dhe zhavor. Në atë moment, vëllai i tij, djali i xhaxhait S.V. \_\_\_\_\_, dhe R.R. \_\_\_\_\_ erdhën në depo nga drejtimi i restorantit të quajtur "\_\_\_\_\_", gjithashtu dhe disa persona të tjera (tridhjetë, dyzet ose pesëdhjetë), të cilët ishin duke u fshehur nga të shtënat. Dëshmitari pretendon se, ndërsa ai po ekte drejt kutive, ai e pa R.R.\_\_\_\_\_ të parkojë veturnën e tij \_\_\_\_\_ para restorantit "\_\_\_\_\_", dhe ai e pa atë dhe S.V. \_\_\_\_\_ duke ecur në drejtim të depos së tij. Por ai nuk e mban mend në mënyrë specifike ndonjë person tjetër që kishte ardhur ose ndonjë veturnë tjetër të parkuar, edhe pse ka pasur shumë njerëz dhe vutura aty. Sipas mendimit të tij, të shtënat kanë zgjatur rreth pesë deri gjashtë minuta. Kur ato u ndalën, R.R. \_\_\_\_\_ u nis në drejtim të \_\_\_\_\_, ndërsa S.V. \_\_\_\_\_ u nis për në shtëpinë e tij e cila është rreth katërqind metra larg nga depoja. Ai mban mend çdo detaj në lidhje me R.R. \_\_\_\_\_ nga momenti kur e ka

parkuar veturën e tij para restorantit " \_\_\_\_\_ " derisa ai u largua nga depoja dhe nga ajo zonë.

Dëshmitari M.K. \_\_\_\_\_ deklaroi se më 26 korrik 2011, në momentin kur kolona e \_\_\_\_\_ ishte gjuajtur në fshatin \_\_\_\_\_, ai erdhi së bashku me R.V. \_\_\_\_\_ në hyrje të depos në fshatin \_\_\_\_\_, nga drejtimi i \_\_\_\_\_. Ata arritin aty me veturën e V.1. \_\_\_\_\_ dhe e parkuan veturën në anën e djathtë të rrugës sepse ata nuk mundën të shkojnë më tutje pasi aty kishe shumë vetura njerëz. Ai theksoi se aty ishin 200 apo 300 persona, dhe ndoshta 50 deri në 100 vetura. E gjithë rruga ishte e bllokuar. Ai dëgjoi të shtënati derisa ata ishin duke dalë nga vetura e tyre. Pasi të shtënati ishin duke vazhduar në atë moment, të gjithë ishte duke vrapuar dhe duke kërkuar strehim. Ata shkuan në këmbë në drejtim të depos dhe në këtë vend ai i pa **R.R.** \_\_\_\_\_ së bashku me S.V. \_\_\_\_\_ duke u fshehur. Pasi kanë ndaluar të shtënati, njerëzit filluan të shpërndahen. Ai më tej shpjegoi se ai shkoi në fshatin \_\_\_\_\_, sepse ishte dëgjuar një alarm se diçka po ndodhët në fshatin \_\_\_\_\_ dhe gjithë njerëzit shkuan atje. Kështu, ai shkoi me "popullin e tij".

Dëshmitari Z.D. \_\_\_\_\_ deklaroi se më 26 korrik 2011 ai ishte në \_\_\_\_\_ dhe i dëgjoi disa njerëz duke thënë se një problem ishte në \_\_\_\_\_. Ai e pa një turmë të njerëzve duke lëvizur lart e poshtë në mënyrë të furishme. Pasi shumica e të afërmve të tij të ngushtë jetojnë në \_\_\_\_\_, ai ishte i shqetësuar për ta, kështu që ai e mori veturën e tij dhe shkoi në \_\_\_\_\_. Kur ai arriti te depoja në fshatin \_\_\_\_\_ që ndodhet në rrugën për në \_\_\_\_\_, ai e parkoi veturën e tij në anën e djathtë të rrugës, sepse ai i pa shumë njerëz aty. Ai u drejtua në drejtim të depos dhe, diku ndoshta 50 metra larg nga depo, ai dëgjoi të shtëna. Ai u strehua prapa disa veturave në këtë parking në anën e djathtë të rrugës, sikurse edhe njerëz të tjerë që ishin rrëth tij. Ai qëndroi aty deri sa të shtënati u ndalen dhe derisa ai i pa njerëzit ngadalë duke u larguar nga strehimi që kishin marrë prapa këtyre veturave. Kur ai u ngrit, ai e pa **R.R.** \_\_\_\_\_ duke qëndruar në këmbë në anën tjetër të rrugës te depo së bashku me S.V. \_\_\_\_\_. Por ai nuk mban mend të kishte parë ndonjë person tjetër. Në atë moment gruaja e tij e thirri në telefon dhe ai u kthye në \_\_\_\_\_.

Dëshmitari D.D. \_\_\_\_\_ deklaroi se më 26 korrik 2011, si çdo ditë tjetër pune, ai ishte në zyrën e tij në \_\_\_\_\_, kur ai mori një telefonatë nga ndërtuesit që punonin në shtëpinë e tij dhe ata kishin nevojë për disa materiale. Ata kishin mungesë të kabllos dhe disa priza elektrike. Kështu, ai shkoi në depon në fshatin \_\_\_\_\_, ku ai bleu materialin për gjithë shtëpinë. Atje ai e pa pronarin e depos S.V.1. \_\_\_\_\_. Dëshmitari hyri në zyrën e tij për dhjetë minuta dhe pastaj ata dëgjuan një numër të madh të veturave duke kaluar në rrugë. Ata dolën jashtë për të parë se çfarë po ndodhë, dhe pasi hynë në ambientet e depos, ata papritmas dëgjuan të shtënati. Në atë moment, automjetet që ishin në rrugë, filluan të ndalen dhe njerëzit filluan t'i lënë ato të dyja anët, në anën e majtë dhe në të djathtë. Pastaj dëshmitari e pa një veturë e cila mbërriti nga drejtimi i \_\_\_\_\_. Ajo u ndal para depos në parking. Pastaj ai e pa se nga vetura, në anën

e pasagjerit, ishte S.V. \_\_\_\_\_ duke dalë nga vetura, dhe në anën tjetër ai e pa **R.R.** \_\_\_\_\_. Ata të gjithë filluan të ikin, dhe ata dy qëndruan pranë dëshmitarit prapa blloqeve të betonit. Ai e mban mend veturën e **R.R.** \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_), sepse ai ishte i vetmi që kishte këtë lloj dhe markë të veturës në \_\_\_\_\_. Pasi ndaluan të shtënët ata u ndanë. D.D. \_\_\_\_\_ shkoi në \_\_\_\_\_ drejtë e në punë. Ai supozon se edhe **R.R.** \_\_\_\_\_ shkoi në Z.P. \_\_\_\_\_.

I pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ deklaroi se, dita kritike, filloi, për të, pikërisht si çdo ditë tjetër të zakonshme pa ndonjë shenjë se diçka mund të ndodhë ndodhë. Në mëngjes ai e piu një kafe me mikun e tij S.V. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_, në restorant "\_\_\_\_\_". S.J. \_\_\_\_\_ ishte poashtu aty. Pastaj, S.V. \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri shkuan në kafenenë "\_\_\_\_\_", në \_\_\_\_\_, ku ata u ulën dhe porositën limonadë. Rreth mesditës dëgjuan alarmin që njoftonte për gjendje të jashtëzakonshme. Duke ndjekur turmën e njerëzve, së pari ata shkuan te një pikë karburanti në rrugën kryesore për Mitrovicë, ku dëgjuan njerëz duke thënë: "Të shkojnë në \_\_\_\_\_. I pandehuri mendonte se atje ishte një barrikadë. Kështu, S.V. \_\_\_\_\_ dhe ai hipën në veturën e të pandehurit për të shkuar në \_\_\_\_\_. Rruga ishte e mbushur me njerëz dhe vetura, por ata arritën të hyjnë në kolonën e veturave që shkonin në \_\_\_\_\_. Kur ata arritën te restorant "\_\_\_\_\_ \_\_\_\_\_", e cila ishte në rrugën për në \_\_\_, në fshatin \_\_\_, ata u ndalën. Në atë moment ai dëgjoi të shtëna që vinin nga drejtimi i \_\_\_, për ku ishin nisur ata. Prandaj, ata shkuan në depon e magazinës që ishte aty, dhe pastaj i pandehuri qëndroi prapa murit të betonit dhe arkës elektrike. Ai theksoi se i ka parë aty S.V.1. \_\_\_\_\_, D.D. \_\_\_\_\_ dhe M.K. \_\_\_\_\_, si dhe Z.J. \_\_\_\_\_. Kur vërejti veturat duke lëvizur përsëri, ai hipi në veturën e tij dhe shkoi në \_\_\_, ku ai \_\_\_ me nënën e tij. Gjatë rrugës për në \_\_\_ ai vuri re disa vetura, dy \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, në pozitë të parregullt, me xhamë të thyer dhe të shpërndarë përgjatë rrugës. Por, ai nuk kishte asnjë ide se \_\_\_\_\_ ishte e pranishme aty. Ai mbërriti në shtëpi dhe kuptoi se çdo gjë ishte në rregull aty, kështu që ai shkoi për të peshkuar në lumin e afërt. Përgjatë rrugës ai u takua me fqin e tij B.K. \_\_\_\_\_ i cili i tha se të shtënët kishin qenë për shkak të barrikadës në rrugë. I pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ pretendon se ai nuk ishte i përfshirë në vendosjen e barrikadës, ai nuk ishte në të dhe ai fare nuk e ka parë atë ditë autokolonën e \_\_\_\_\_.

Gjatë shqyrimit kryesor i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ e ushtroi të drejtën e tij të mos deklarohet.

Duke vlerësuar të gjitha provat e paraqitura në shqyrtimin kryesor, Trupi Gjykues arriti në përfundim se nuk është provuar se i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ kanë kryer veprat penale nën akuzat 1), 2), 3), 5), 6) dhe 7) të Aktakuzës, por është provuar se kanë kryer veprën penale të përshkruar nën akuzën 4) të Aktakuzës.

Trupi gjykues gjen faktet në vijim të dëshmuara:

Vetura e parë e kolonës së \_\_\_\_\_, një veturë e blinduar që ishte duke udhëhequr kolonën e \_\_\_\_\_ që ishte drejtuar në drejtim të Portës \_\_\_, ishte duke u vozitur nga \_\_\_\_\_ E.D. \_\_\_\_\_ me \_\_\_\_\_ I.S. \_\_\_\_\_ në ulësen e përparme të pasagjerit. Vetura kishte dy ulëse në pjesën e pasme përgjatë mureve anësore të automjetit. Në pjesën e pasme ishin ulur \_\_\_\_\_ F.U. \_\_\_\_\_, N.S. \_\_\_\_\_ and S.S. \_\_\_\_\_. Shefi i \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ (kolonës) ishte I.A. \_\_\_\_\_ i cili ishte pasagjeri përparrë në një veturë "jo të blinduar", të drejtuar nga F.A.1. \_\_\_\_\_, e cila veturë ishte mu prapa veturës së blinduar. Në veturën "jo të blinduar" që ishte prapa automjetit të blinduar ishin E.Z. \_\_\_\_\_, si shofer, së bashku me B.M. \_\_\_\_\_ dhe D.P. \_\_\_\_\_. Kur kolona hasi në barrikadën e dytë të bërë nga vetura, është detyruar të ndalojë. Diku tetë persona dolën nga veturat dhe filluan të përballen me \_\_\_\_\_ së Kosovës duke bërtitur, sharë dhe duke bërë me gjeste ndaj \_\_\_\_\_. Pas pak çastesh, edhe një veturë u afroa dhe u ndal në një distancë nga barrikada. \_\_\_\_\_ I.S. \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ urdhëruan personat të cilët kishin bllokuar dhe e pengonin autostradën publike të heqin pengesat dhe të largonin veturat e tyre, por ata nuk e përfillën atë urdhër dhe vazhduan të ulërinin dhe bërtisnin në \_\_\_\_\_, duke bërë me gjeste dhe duke ngritur tre gishtat dhe gishtin e mesëm ndaj \_\_\_\_\_. Në këtë pikë udhëheqësi i operacionit \_\_\_\_\_ I.A. \_\_\_\_\_ dha urdhër që automjeti i blinduar të shtyjë tutje veturat e barrikadës. Sapo vetura e blinduar iu afroa automjeteve që kishin bllokuar rrugën, personat që ishin duke qëndruar afër barrikadës u larguan dhe hynë në pyll që gjendej në anën e majtë. Në të njëjtën kohë u dëgjua e shtëna e parë dhe u qëllua \_\_\_\_\_ E.Z. \_\_\_\_\_. Pastaj, gjuajtje të shpejta filluan kundër autokolonës së \_\_\_\_\_ nga tri drejtime të ndryshme. \_\_\_\_\_ u përgjigjën me të shtëna në mënyrë që të mbrojnë veten e tyre, por ata u desh të tërhoqeshin dhe të dërgonin E.Z. \_\_\_\_\_ në Qendrën Emergjente në Mitrovicë dhe më pas me helikopter në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, ku edhe vdiq si rezultat i plagëve.

Për sa i përket akuzave "**Vrasje e rëndë", "Vrasje e rëndë në tentativë", "Mbajtja e paautorizuar e armëve në pronësi, në kontroll, në posedim ose në përdorim**":

Trupi Gjykues gjen se barrikada e veturave e cila detyroi kolonën e \_\_\_\_\_ të ndalojë dhe të shtënat që pasuan ndaj kolonës kur kolona filloj të largojë barrikadën, që, në fund detyroi \_\_\_\_\_ të tërhoqet, ishte një operacion i mirë organizuar. Në këtë pjesë të rrugës, për shkak të terrenit, sikurse ka mundur të vërejë trupi gjykues gjatë inspektimit të vendit të ngjarjes dhe siç mund të shihet në fotografitë e vendit të krimtit, ishte e lehtë të krijohet një barrikadë e cila ishte e pamundur të kalohet. Më tej terreni ofrojë mbulesë të mirë për ata të cilët gjuajtën me armë në drejtim të kolonës. Më tej, në atë pikë telefonat mobil dhe radio lidhjet nuk ishin funksionale. Është me rëndësi të përmendet këtu se asnjëri nga \_\_\_\_\_, të cilët janë intervistuar si dëshmitar gjatë procedurës, nuk ka parë njerëz që bartnin armë zjarri. Pra, nuk mund të konstatohet nëse personat në barrikadë ishin të njëjtë persona të cilët menjëherë pastaj filluan të shtënat nga pylli. Megjithatë, trupi gjykues gjen se duhet të ketë qenë ndonjë lidhje në mes të paktën një ose më shumë personave në barrikadë dhe gjuajtësve. Trupi Gjykues nuk

beson se krijimi i barrikadës dhe të shtënët ishin një rastësi e thjeshtë. Mund të jetë se ata që organizuan operacionin menduan se kolona do të ndalet dhe të kthehet prapa, për shkak të barrikadës. Megjithatë, kur kolona u përpoq të pastrojë rrugën, filloi sulmi me armë zjarri në drejtësim të autokolonës. Në këtë pikë, gjuajtësit ishin tashmë në pyll, gati për të sulmuar.

Parimi bazë i të drejtës penale është se çdo përgjegjësi penale varet nga një veprim apo mosveprim i bërë nga i pandehuri. Kjo "kërkësë akt" nuk është përbushur në këtë rast në lidhje me akuzat 1), 2) dhe 3) të Aktakuzës. Nuk është vërtetuar se ndonjë nga të pandehurit kishte armë apo se ata kishin shtënë. Gjithashtu nuk është vërtetuar se ata u përpoqën për të privuar E.Z. \_\_\_\_\_ ngajeta, apo të kishin pasur qëllim për të privuar atë ose ndonjë person tjetër ngajeta, madje as që e kanë ndërmarrë ndonjë veprim apo se ata e kanë ditur që persona tjerë mund të ndërmarrin veprime që çuan në vrasjen e E.Z. \_\_\_\_\_.

Prandaj të pandehurit duhet të lirohen sipas Nenit 364 paragrafi (1), nënparagrafi (1.3) të KPP të kenë kryer veprat penale:

- “**Vrasje e rëndë**” e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të KPP e lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPP *pari materia* të Neneve 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK, akuza 1) e aktakuzës;
- “**Vrasje e rëndë në tentativë**” e përshkruar dhe e dënueshme sipas Neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të KPP e lexuar në lidhje me Nenet 20 dhe 23 të KPP *pari materia* të Neneve 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK e lexuar në lidhje me Nenet 28 dhe 31 të KPRK, akuza 2) e aktakuzës;
- “**Mbajtja e paautorizuar e armëve në pronësi, në kontroll, në posedim ose në përdorim**” në kundërshtim me Nenin 328 (1) dhe (2) të KPK e lexuar në lidhje me Nenin 23 KPP *pari materia* me Nenin 374 të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK, akuza 3) e aktakuzës.

Për sa i përket akuzave “**Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme**” dhe “**Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm**”:

Për sa i përket akuzave nën akuzën 5) të Aktakuzës, “**Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme**” e përshkruar dhe e dënueshme nën Nenin 299 (1) të KPK i lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPP *pari materia* të Nenit 380 të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK dhe akuzat nën akuzën 6) të aktakuzës, “**Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm**” në kundërshtim me Nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK i lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPP *pari materia* të Nenit 365 të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK, Trupi Gjykues thekson se ekziston një lidhje e bashkimit në mes të këtyre dy dispozitave ligjore. Bashkimi i vërtetë e veprave lind kur kryerësi kryen më shumë se një krim, qoftë duke shkelur të

njëjtën dispozitë disa herë, ose duke shkelur një numër dispozitash të ndryshme me veprime të veçanta. Bashkimi real i dukshëm mund të lind kur një seri veprimeve të veçanta, por të lidhura ngushtë, përm bushin të gjitha elementet e një vepre të caktuar penale, por janë konsideruar si një e vetme, edhe pse krim i vazhdueshëm. Bashkimi ideal i referohet situatës ku një akt i vetëm apo gjendja faktike përbëjnë më shumë se një krim. Për më tepër, bashkimi i dukshëm ideal për vepra penale lind kur një marrëdhënie bashkimi zgjidhet me zbatimin e metodave analitike të mëtejshme. Pikënisja e kësaj analize është një krahasim i elementeve të ndryshme të kimeve, në mënyrë që të përcaktohen specifikat reciproke. Parimi i subsidiaritetit është aplikuar si një metodë shtesë për të përcaktuar drejtësinë e bindjeve kumulative për bashkim ideal. Subsidiariteti i referohet marrëdhënieve në mes veprave penale të llojit të njëjtë të cilat janë të definuara të mbrojnë të njëjtat apo intereset shoqërore të lidhura afërsisht, por të cilat dallojnë për sa i përket elementeve të caktuara. Në rrethana të tilla, krimi special konsumon krimin e përgjithshëm. Megjithatë, në aktakuzë, Prokurori ka përdorur parimin e bashkimit real për asnjë qëllim të dukshëm. Për një veprim, të pandehurit ishin akuzuar me dy kime edhe nëse fjalia e përgjithshme "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" tanimë është mbuluar dhe mishëruar në elementet e Nenit 299 të KPK. Pra, i njëjti rezultat (vënia në rrezik) është përdorur në dy dispozita të ndryshme. Trupi Gjykues duhet të theksoj se vepra penale e paraparë në Nenin 291 të KPK paraqet aktin e përgjithshëm kriminal në lidhje me vepra të tjera penale nga ky kapitull, i cili manifestohet në forma të veçanta, dmth aspekte të veçanta të këtij akti të përgjithshëm kriminal. Në fakt, vepra penale "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" përmban edhe karakteristikat e rëndësishme të Nenit 299 të KPK-së. Të dy krimet dënojnë shkeljet e të njëjtës vlerë penale (duke rrezikuar jetën apo trupin e personave ose për pronën e konfiskueshme, jo vetëm nga veprimet ose mjetet e përmendura në mënyrë eksplikite në ligj), por me forma të ndryshme të veprimit (një "nga një tjetër" veprim përgjithësisht i rrezikshëm ose mjete në përgjithësi të rrezikshme, tjetër me pëershkrim të plotë të formës specifike të veprimeve). Karakteri subsidiar i këtij krimi (Neni 291 i KPK-së), rezulton edhe nga karakteri i saj i përgjithshëm, sepse ajo ekziston vetëm në qoftë se karakteristikat ligjore të një vepre tjetër penale nga dy kapitujt nuk janë plotësuar në rastin konkret. Për këtë arsyе trupi gjykues mund të konkludojë se kemi një bashkim real në bazë të subsidiaritetit të këtyre dy dispozitave penale. Për më tepër, në lidhje me këtë akuzë ("Rrezikimi i trafikut publik me veprim të rrezikshëm apo mjete"), Trupi Gjykues duhet të theksoj se asnjë fakt nuk është provuar që mund të demonstrojë se të pandehurit, kanë kryer vepër të tillë penale.

Kjo është kështu sepse Paragrafi 1 i Nenit 299 të KPK (Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme) thotë:

*"Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, jep shenja ose sinjale të gabueshme, vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon trafikun dhe kështu vë në rrezik jetën e njeriut, sigurinë fizike apo pasurinë në përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në tri vjet".*

Elementi objektiv i kësaj dispozite penale është një veprim i cili mund të shkaktojë rrezik konkret (real dhe të menjëhershëm) për jetën ose trupin e personave ose për pronën. Në këtë rast i vetmi veprim i kryer nga të pandehurit të cilët ishin në barrikadë ishte krijimi i pengesës konkrete kolonës së \_\_\_\_\_ në mënyrë që t'i pengojnë ata të mbërrijnë te Porta \_\_\_. Kjo barrikadë në vete nuk ka shkaktuar ndonjë rrezik konkret ndaj \_\_\_\_\_. Ishin të shtënat me armë zjarri dhe krijimi i një prite që vau E.Z. \_\_\_\_\_ dhe vuri në rrezik personat që ishin në kolonën e \_\_\_\_\_. Prandaj, pa një lidhje të fortë në mes të shtënavëve dhe barrikadës, të pandehurit nuk mund të dënohen si kryerës të këtyre dy akuzave penale.

Si pasojë, të pandehurit janë liruar, sipas Nenit 364 paragrafi (1) nënparagrafi (1.3) të KPK të kenë kryer veprat penale:

- “Rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme” e përshkruar dhe e dënueshme nën Nenin 299 (1) të KPK i lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPP *pari materia* të Nenit 380 të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK dhe akuzat nën akuzën 5) të aktakuzës,
- “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm” në kundërshtim me Nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK i lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPP *pari materia* të Nenit 365 të KPRK e lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK, akuza 6) e aktakuzës.

#### **Për sa i përket akuzës “Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale”:**

Neni 320 të KPK (Pjesëmarrja në grup që kryen vepër penale) thotë:

“(1) Kushdo që merr pjesë në një turmë të mbledhur, e cila me veprime kolektive e privon personin ngajeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjeter, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmon pasurinë në përmasa të mëdha ose kryen vepra të tjera të shkeljeve të rënda apo tenton të kryejë vepra të tillë dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.”

Neni 412 të KPK (Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi) thotë:

“1. Kushdo që merr pjesë në turmën e mbledhur prej më tepër se tetë personave, e cila me veprime të përbashkëta e privon personin tjeter ngajeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjeter, shkakton rrezik të përgjithshëm, shkakton dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë ose kryen vepra tjera të rënda të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim apo tenton të kryejë vepra të tillë, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

Nën dispozitën e vjetër, ishte mendim i përgjithshëm se turma duhet të jetë më e madhe se shtatë (7) apo së paku dhjetë (10) persona. Megjithatë, ajo gjithashtu thotë:

*“duke pasur parasysh, në anën tjetër, se krijimi i turmës është zakonisht një akt spontan dhe si pasojë nuk është i lidhur me numrin konstant të pjesëmarrësve [numri luhatet, rritet dhe zbritet, varësisht në zhvillimi i ngjarjeve], nuk është e këshillueshme të caktohet paraprakisht një numër [i personave] si prag, në vend të kësaj duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur në secilin rast, duke marrë parasysh shumë rrethana”.*

Qëllimi i kësaj dispozite është që të dënojë organizimin e tubimit, jo për krijimin e një grupi që ka kryer një pritë. Zakonisht, tubimi është i rrezikshëm pikërisht për shkak se i ka reagimet e veta të cilat janë të pavarura nga reagimi i anëtarëve të saj. Në këtë formë, një tubim është i ndryshëm nga një grup, i cili është në përgjithësi i kufizuar sa i përket numrit të pjesëmarrësve, ka një vetëdije dhe është i organizuar. Një tubim i vërtetë është turmw e paorganizuar [kaotike], edhe pse termi tubim/turmë mund të zbatohet edhe kur ka një sasi e caktuar [më e vogël ose më e madhe] e rendit dhe organizimit. Kështu, përfshirja e të pandehurve në krijimin e vetë barrikadës, në këtë rast, është më afér një grupi se sa një tubimi të vërtetë ose turme për shkak të numrit të njerëzve. Prandaj, në bazë të Kodit të vjetër, ky trup gjyques nuk mund të vendosë se personat e pranishëm në barrikadë ishin të paktën 10. Në fakt, asnjë nga dëshmitarët e përmendur më lartë (\_\_\_\_\_ Kosovës që ishin në dy veturat e para) për këtë çështje nuk kanë deklaruar se kanë qenw më shumë se tetë persona në barrikadë. Sipas Kodit të ri, ky element objektiv i akuzës penale është zvogëluar dhe vendosur më shumë se tetë (8) persona.

Pasi trupi gjyques nuk ka mundur të vendosë se në barrikadë ishin më shumë se tetë (8) persona, një element i dispozitës penale nuk ka mundur të dëshmohet prandaj të pandehurit janë liruar sipas Nenit 364 parografi (1) nënparografi (1.3) të KPK të kenë kryer veprën penale “Pjesëmarraja në grup që kryen vepër penale”, e përshkruar dhe e dënueshme sipas Nenit 320 (1) të KPK e lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK pari materia e Nenit 412 të KPRK lexuar në lidhje me Nenin 31 të KPRK,akuza 7) e aktakuzës.

#### **Për sa i përket akuzës “Pengimi i personit zyrtar nw kryerjen e detyrave zyrtare”:**

Kur Trupi Gjyques gjen se të dy të pandehurit R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_ ishin në barrikadë me një grup të njerëzve, dhe në mënyrë të paligjshme penguan kolonën e \_\_\_\_\_ së Kosovës, Trupi Gjyques mbështetet në deklaratat e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_ deklarata e të cilit është e mbështetur nga deklaratat e dëshmitarëve I.S. \_\_\_\_\_, N.S. \_\_\_\_\_, S.S. \_\_\_\_\_ dhe E.D. \_\_\_\_\_, dhe më tutje nga deklaratat e V.K. \_\_\_\_\_, F.Z. \_\_\_\_\_, M.J. \_\_\_\_\_, F.F. \_\_\_\_\_, I.L. \_\_\_\_\_, B.M. \_\_\_\_\_ B.P. \_\_\_\_\_, K.H. \_\_\_\_\_, M.S. \_\_\_\_\_, F.A. \_\_\_\_\_, G.C. \_\_\_\_\_, H.H. \_\_\_\_\_, K.K. \_\_\_\_\_, A.I. \_\_\_\_\_, G.D. \_\_\_\_\_ dhe V.R. \_\_\_\_\_. Kjo gjithashtu mbështetet në deklaratën e dëshmitarit B dhe dëshmi të tjera dhe dëshmi të tjera vërtetuese gjatë vizitës në vendngjarje, raportet e komunikimeve, harta e prezantuar nga \_\_\_\_\_ e telefonisë dhe raporti i Policisë së EULEX-it.

Dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ e ka njojur dukjen e R.R. \_\_\_\_\_. Ai e ka njojur atë në barrikadë edhe pse ai nuk ishte i sigurt për mbiemrin e tij, a ishte R. \_\_\_, R.1. \_\_\_, apo R.2. \_\_\_. F.U. \_\_\_ gjithashtu deklaroi se ai e ka njojur R.R. \_\_\_\_\_ nga dukja për 20-25 vite pasi ata kanë \_\_\_ në \_\_\_ afër njëri me tjetrin. Kur i është treguar atij Albumi fotografik, ai e pa aty fotografinë e R.R. \_\_\_\_\_ dhe ai e identifikoi atë si pjesë e grupit të njerëzve të cilët dolën nga veturat të cilat kishin formuar barrikadën \_\_\_\_\_ së Kosovës. F.U. \_\_\_ e njoju R.R. \_\_\_\_\_ në vend dhe pastaj në Albumin fotografik dhe më vonë ai e mësoi mbiemrin e tij. Një javë apo dhjetë ditë para incidentit përkates, F.U. \_\_\_\_\_, bashkë me të ndjerin E.Z. \_\_\_\_\_, e kishin ndaluar R.R. \_\_\_\_\_ në një pikë kontrolli të rregullt. Më tej, kur vetura e blinduar ishte në barrikadë, F.U. \_\_\_\_\_ menjëherë u tha kolegëve të tij se i njoju disa nga personat në barrikadë. Dëshmitarët I.S.\_\_\_\_\_, N.S. \_\_\_, S.S. \_\_\_\_ dhe E.D. \_\_\_\_\_ i dhanë deklaratat e tyre në përputhje me deklaratën e F.U. \_\_\_\_\_ duke vërtetuar se ai njoju personat në barrikadën e dytë dhe, aty në vend, ai tha se i njihte ata. Ata të gjithë pohuan se I.S. \_\_\_\_\_ i sugjeroi F.U. \_\_\_\_\_ të vëzhgojë personat në barrikadë me kujdes në mënyrë që t'i mbajë mend ata. Të gjithë dëshmitarët e përmendur më lartë më tej deklaruan se F.U. \_\_\_\_\_, i cili fillimisht ishte i vendosur në pjesën e prapme të veturës së blinduar, u ngrit dhe iu afroa mesit në mes vozitësit dhe pasagjerit të parë për të pasur dukshmëri më të mirë. Edhe F.U. \_\_\_\_\_ deklaroi se ai kishte të njëjtën dukshmëri nga brendia e veturës së blinduar sikurse vozitësi. Kështu ai ishte në gjendje të vëzhgojë këta persona dhe në mesin e tyre i njoju katër persona përfshirë R.R. \_\_\_\_\_, dhe ai e mbante mend pamjen e M.V. \_\_\_\_\_ fotografinë e të cilat ai e identifikoi në Albumin fotografik.

Dëshmitari dha vlerësim të përafërt për largësinë mes njerëzve në barrikadë dhe pjesës së përparmë të konvojit të \_\_\_ kur konvoji u ndal, por të gjithë ata konfirmuan se dukshmëria nga vetura, pavarësisht xhamit të përparmë të ndarë të saj, ishte e qartë, e mirë dhe e mjaftueshme. Trupi gjykues po ashtu merr në konsideratë se pa matje të saktë, është e vështirë të jepet një vlerësim preciz i largësisë që ilustrohet në deklaratat e dëshmitarëve, por personat në barrikadë kishin qëndruar afër veturave në barrikadë deri sa vetura e blinduar filloj ta largonte barrikadën, dhe pastaj ata ishin larguar. Kjo tregon se çfarëdo që të ketë qenë largësia më parë, kur vetura e blinduar u ndal te barrikada dhe deri sa ata ikën nga aty, largësia deri te personat ishte zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. Në fund, trupi gjykues ka vërejtur se vetura e blinduar është e autorizuar për ngasje në rrugët publike, gjë që tregon se dukshmëria nga brenda duhet të jetë e tillë që është e mundur të nijhen njerëzit jashtë. Prandaj, trupi gjykues beson se F.U. \_\_\_\_\_ ka qenë në gjendje të shoh dhe të vëzhgojë personat te barrikada. Në të vërtetë, të gjithë \_\_\_\_\_ që kanë qenë në veturën e blinduar i kishin parë këta njerëz, por vetëm F.U. \_\_\_\_\_ i njihte disa prej tyre.

Nga numri i madh i thirrjeve telefonike dhe i porosive me SMS (gjithsej 69) të bëra nga i pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ para, gjatë dhe pas incidentit, trupi gjykues vjen në përfundim se gjatë asaj dite ai ishte aktiv në pjesën më të madhe të saj. Gjykatës nuk i janë dhënë përbajtjet e thirrjeve telefonike të bëra nga ai ose përbajtja e porosive të dërguara, por shkresat e lëndës përbajnjë të dhëna në lidhje me regjistrimin e pozitës së telefonit të të pandehurit R.R.

\_\_\_\_\_. Sipas identifikimit të telefonit celular, më 26 korrik 2011, mes orës 14:13 dhe 14:17, telefoni i të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte nën antenën e \_\_\_\_\_ (nr. 11574). Megjithatë, në orën 14:18, telefoni i të pandehurit e shfrytëzonte antenën e \_\_\_\_\_ (nr. 11503). Në orën 14:23, telefoni i tij e shfrytëzonte sërish antenën e \_\_\_\_\_. Si rezultat i kësaj, nga këto prova materiale, gjykata mund të vijë në përfundim se i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte te ose përreth vendit të barrikadës në kohën e sulmit kundër konvojit të \_\_\_\_\_ së Kosovës. Ku, sipas hartës së paraqitur nga kompania serbe e telefonisë, vendi ku gjendet depoja në fshatin \_\_\_\_\_ është pak a shumë ndërmjet dy antenave përkatëse, domethënë antenës nr. 11574 dhe antenës nr. 11503.

Sipas komunikimeve me radio, sulmi kishte ndodhur në orën 14:15 dhe të shtënët kishin zgjatur për të paktën 15 minuta. Trupi gjykues posaçërisht thekson se të dhënat e paraqitura në raportin e Policisë së EULEX-it tregojnë se i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte te barrikada deri në orën 14:17h, pastaj ishte zhvendosur te depoja, dhe pastaj sërish kishte shkuar te barrikada, skenar ky që ka shumë të ngjarë. Në deklaratën e tij, ai në fakt deklaroi se kur ishin ndalur të shtënët, ai menjëherë kishte shkuar në \_\_\_\_\_ në shtëpinë e tij. Gjatë rrugës së tij, ai duhet ta kalonte pikën ku ishte ngritur barrikada, çfarë ai e konfirmoi. Nga këqyrja e vendit, trupi gjykues e di me siguri se largësia nga pika A (domethënë, barrikada e dytë) deri në pikën B (depoja) është 674 metra. Duke përdorur njohuritë e përgjithshme, trupi gjykues gjithashtu e di se shpejtësia normale e të ecurit është 5 kilometra në orë. Kështu që, trupi gjykues mund të vijë në përfundim se të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_ do t'i ishin dashur disa minuta, ecje me shpejtësi normale, që të ekte nga pika A deri në pikën B. Për më tepër, gjykata po ashtu duhet të theksojë se i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ është/ishte sportist. I pandehuri duket të jetë në gjendje të mirë shëndetësore, kështu që, nëse ishte e nevojshme, i pandehuri ka mundur të ekte më shpejt ose madje edhe të vraponte në atë largësi. Prandaj, trupi gjykues beson se dëshmitari B e kishte parë të pandehurin **R.R.** \_\_\_\_\_ afër depos, që gjendet afër barrikadës së dytë, pas ose gjatë pjesës së fundit të të shtënave, kur **R.R.** \_\_\_\_\_ tashmë kishte arritur atje nga pika ku ishte vënë barrikada. Kjo tregon se **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte te barrikada kur konvoji i \_\_\_\_\_ së Kosovës u detyrua të ndalej atje. Trupi gjykues konstaton se deklarata e dëshmitarit B është e besueshme dhe koherente. Dëshmitari B nuk ka lidhje me të pandehurit dhe akti i dëshmitarit që të del e të dëshmojë tregon një kurajo të madhe. Kështu që trupi gjykues konstaton se dëshmitari B është krejtësisht i besueshëm në opinionin e këtij trupi gjykues.

Më tej, sipas dëshmitarit B, pasi ishin ndalur sirenat, ai/ajo e pa një grup personash, civil me armë zjarri, afër depos. Dëshmitari B po ashtu deklaroi se ai/ajo e pa shpërndarjen e armëve dhe të municioneve në \_\_\_\_\_ (tipi AK-47). Dhe në fund dëshmitari B tha se ai/ajo pa rreth 10 persona në atë vend dhe kohë. Deklarata e paraqitur e dëshmitarit B është e kundërt me deklaratat e dëshmitarëve të alibisë së **R.R.** \_\_\_\_\_ sa i përket numrit të personave të cilët ishin të pranishëm në afërsi të depos në ditën e incidentit. Siç u tha, dëshmitari B dëshmoi se ishin vetëm 10 persona ndërsa të gjithë dëshmitarët që kanë dëshmuar në favor të alibisë së të pandehurit kanë deklaruar se ka qenë 200-300 persona afër depos. Asnjëri nga këta dëshmitarë nuk e ka përmendur se kishte civilë që mbanin armë zjarri, siç u deklarua nga dëshmitari B. Këto mospërputhje ndërmjet deklaratave të dëshmitarit B dhe të dëshmitarëve të alibisë janë serioze. Më tej, dëshmitarët e alibisë kanë dhënë një përshkrim jashtëzakonisht të detajuar dhe preciz, për shembull lëvizjet e tyre dhe se çfarë kanë porositur nëpër kafene, ku **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte ulur në kafene, çfarë rrobe kishte të veshura ai, me kë ishte, çfarë lloj vture kishte ai, ku ishte parkuar, para më shumë se katër vjetësh. Po ashtu, atyre u kujtohej se e kishin parë njëri-tjetrin. Detajet e

tilla, sipas mendimit të trupit gjyques, normalisht të vështira për t'u mbajtur në mend pas shumë vjetësh, madje edhe nëse merret parasysh ngjarja e jashtëzakonshme – të shtënati – që kishte ndodhur atë ditë. Në anën tjetër, asnjërit prej tyre nuk i kujtohej ndonjë person tjetër që ishte pjesë e grupit të njërzve në rrugën për në \_\_\_\_\_ ose afër depos ndonëse ata vlerësuan se grupei ishte prej 100, 200 ose madje 300 njërzve. Më tej, dëshmitari S.V. \_\_\_\_\_ deklaroi se pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_, në ditën kritike, para dhe gjatë incidentit/të shtënave mbi konvojin e \_\_\_\_\_, ishte me të në kafene/restorante të ndryshme, dhe në fund, se i pandehuri ishte me të në te depoja në fshatin \_\_\_\_\_. Dëshmitari Z.J. \_\_\_\_\_ e konfirmoi rrëfimin e V. \_\_\_\_\_ duke thënë se ai i kishte parë V. \_\_\_\_\_ dhe **R.R.** \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ një kafene para se të ndodhnin të shtënati kundër konvojit të \_\_\_\_\_ dhe se ata kishin arritur te depoja në të njëjtën kohë, nga drejtimi i \_\_\_\_\_. Dëshmitari Z.M. \_\_\_\_\_ pretendoi se ai e kishte parë **R.R.** \_\_\_\_\_. kur kishin filluar të shtënati sepse **R.R.** \_\_\_\_\_ tashmë ishte te depoja, pavarësisht deklaratës së S.V. \_\_\_\_\_ i cili pretendon se ai ende ishte në \_\_\_\_\_ me **R.R.** \_\_\_\_\_ kur filluan të shtënati. S.V.1. \_\_\_\_\_ konfirmoi se **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte duke u fshehur në afërsi të depos së tij kur ndodhën të shtënati kundër konvojit të \_\_\_, gjersa D.D. \_\_\_\_\_ deklaroi se ai e kishte parë **R.R.** \_\_\_\_\_ duke arritur nga \_\_\_\_\_ dhe duke e lënë veturën e tij afér depos në kohën kur ai dëgjoi të shtënati. Me sa duket të gjitha këto deklarata kanë për synim të vërtetojnë se **R.R.** \_\_\_\_\_ nuk ishte te barrikada. Por ai fakt është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarit U. \_\_\_\_\_ e mbështetur me prova të dhëna nga dëshmitarët e tjera të cekur dhe nga përbajtja e dokumenteve të lartcekura. Për këtë arsy, trupi gjyques vjen në përfundim se të gjithë dëshmitarët të cilët dëshmuan dhe konfirmuan albinë e të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_, domethënë dëshmitari S.V. \_\_\_\_\_, dëshmitari Z.J. \_\_\_\_\_, dëshmitari Z.M. \_\_\_\_\_, dëshmitari S.V.1. \_\_\_\_\_, dëshmitari M.K. \_\_\_\_\_, dëshmitari Z.D. \_\_\_\_\_ dhe dëshmitari D.D. \_\_\_\_\_, nuk e kanë thënë të vërtetën. Përveç tjerash, këta dëshmitarë janë edhe miq të afërt dhe të njobur të **R.R.** \_\_\_\_\_, dhe me sa duket përpiken t'i ndihmojnë atij në krijimin e albisë. Prandaj, ata nuk janë kredibil dhe të besueshëm në lidhje me faktet për të cilat ata dëshmonin, që rezulton në vlerësimin se alibia e **R.R.** \_\_\_\_\_ është e falsifikuar.

Përveç tjerash, duke pasur parasysh përbajtjen e deklaratave të dëshmitarit B para prokurorit, trupi gjyques ka më shumë arsy për të mos besuar se **R.R.** \_\_\_\_\_ ishte në \_\_\_\_\_ kur ishte ngritur barrikada me vetura me qëllim që ta ndalë konvojin e \_\_\_\_\_ së Kosovës. Domethënë, dëshmitari B e përshkroi që më 25 korrik 2011 kishte informata se njësia \_\_\_\_\_ ishte rrugës për në portën \_\_\_\_\_ për ta marrë kontrollin e Portës. Dëshmitari B deklaroi se “kryetari i Komunës së \_\_\_\_\_”, S.R.1. \_\_\_\_\_, i thirri punëtorët e komunës që të mblidheshin. Pastaj R.3. \_\_\_\_\_ u tha njërzve të cilit ishin mbledhur jashtë ndërtesës së komunës që të shkonin te Porta \_\_\_\_\_ për ta bllokuar \_\_\_\_\_. Ai/ajo shpjegoi se njëzit shkuan te Porta \_\_\_, ku S.R.1. \_\_\_\_\_ negocioi me \_\_\_\_\_, dhe se personat nga \_\_\_\_\_ qëndruan te Porta \_\_\_\_\_ deri të nesërmen në mëngjes. Dëshmitari B po ashtu deklaroi se ekziston një sistem paralajmërimi në \_\_\_\_\_ i cili përdoret nga kryetari i komunës. Së pari, kryetari i komunës i thirri njëzit përgjegjës në institucionet e ndryshme komunale dhe pastaj publiku i përgjithshëm paralajmërohet përmes përdorimit të sirenës së alarmit. Në deklaratën e \_\_\_\_\_ të datës 27 nëntorit 2011, në pyetjen e prokurorit, nëse turma qëndroi në Portën \_\_\_\_\_ deri të nesërmen në mëngjes, Dëshmitari B deklaroi (versioni i redaktuar) si vijon:

*“Po, ditën e nesërmë po ashtu kishte disa negociata që bëheshin nga S.R.1 \_\_\_\_\_. Nuk jam i sigurt nëse ai u përpoq të negacione me KFOR-in ose EULEX-in, nuk e di. Kur ai i*

përfundoi negociatat ai iu afroa turmës dhe ai hipi në njëfarë shtrati lulesh prej betonit dhe na tha se ata kishin bërë një marrëveshje që \_\_\_\_\_ të lejohej të kthehej prapa ashtu që askush nuk duhet të sulmonte, të shtinte ose të bënte ndonjë gjë. Pra kur ai na tha të shpërndaheshim njerëzit filluan të lëviznin dhe krijuan hapësirë të lirë që \_\_\_\_\_ të largohej, dhe pastaj \_\_\_\_\_ u largua nga vendi dhe vazhdoi në drejtëm të Mitrovicës pa asnë incident. Kur ata na kaluan neve, S.R.I. \_\_\_\_\_ tha se ne të gjithë mund të shkonim në shtëpi. Ndoshta një orë më vonë kur ne u kthyem në \_\_\_\_\_, unë dhe të tjerët po qëndronim në qendër të \_\_\_\_\_ dhe në atë moment ne dëgjuam sirenën ajrore dhe pastaj ata kishin dëgjuar nga disa persona të tjerë të cilët ishin grumbulluar atje se \_\_\_\_\_ po kthehej dhe ne duhet të shkonim atje dhe t'i blllokoni përsëri. Kur i pashë se të gjithë po shkonin unë iu bashkova atyre dhe shkuam në fshatin \_\_\_\_\_. Unë shkova në fshatin \_\_\_\_\_ me veturë dhe e parkova atë rrëth dy kilometra larg vendit të incidentit dhe pastaj dola nga vetura dhe i dëgjova të shtënat."

Trupi gjykues është i bindur se nuk ka dyshim se F.U. \_\_\_\_\_ e njihte për nga pamja R.R. \_\_\_\_\_ dhe se e kishte mundësinë për këtë, dhe se ai në të vërtetë e njoju R.R. \_\_\_\_\_ te barrikada. Më tej, trupi gjykues është i bindur se ai po ashtu e pa, vëzhgoi dhe më vonë e identifikoi në albumin e fotografive një fotografi të M.V. \_\_\_\_\_ si njërin nga personat te barrikada që kishin për qëllim ta ndalnin konvojin e \_\_\_\_\_ së Kosovës. Dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ e kishte si kohën e mjaftueshme ashtu edhe pamjen për t'i vëzhguar të gjithë personat në barrikadë përfshire R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_. Ai mund t'i vëzhgonte të dy të pandehurit për njëfarë kohe gjersa konvoji u ndal, gjersa personat në barrikadë u urdhëruan të lëviznin, dhe në fund gjersa vetura e blinduar shkoi në drejtëm të barrikadës për t'i larguar veturat.

Trupi gjykues nuk sheh asnë arsy pse F.U. \_\_\_\_\_ të mos e thotë të vërtetën për atë që ai kishte vërejtur. Për më tepër, identifikimi i të pandehurve, të cilët janë të etnisë \_\_\_\_\_, si pjesë e grupit të njerëzve të cilët e ndalën konvojin e Njësisë \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ së Kosovës kur ishte në pjesë veriore të Kosovës vetëm mund t'i \_\_\_\_\_ pasi që ai \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ ku \_\_\_\_\_. Kështu që trupi gjykues mund të vijë në përfundim se deklarata e dëshmitarit F.U. \_\_\_\_\_ është relevante dhe e ndershme. Për më tepër, fakti se dëshmitari F.U. \_\_\_\_\_ e ndali të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_ pak para ngjarjes në një kontroll rutinor të komunikacionit është me rëndësi dhe e forcon vlerën e deklaratave të tij. Andaj, gjykata konsideron se kjo është më e besueshme se sa një identifikim i thjeshtë. Deklarata e tij është mbështetur edhe me deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e lartcekur si dhe nga përbajtja e dokumenteve të paraqitura, gjë që të gjitha së bashku nuk lënë dyshime se i pandehuri R.R. \_\_\_\_\_ dhe i pandehuri M.V. \_\_\_\_\_ ishin te barrikada në momentin kritik. Dhe qëllimi i qartë i vendosje së barrikadës ishte ndalja e \_\_\_\_\_ të Kosovës, të cilët ishin në konvojin e veturave dhe ishin duke i zbatuar detyrat e tyre të ligjshme, për të vazhduar më tej drejt Portës \_\_\_\_\_.

Trupi gjykues nuk i jep peshë të konsiderueshme mospërputhjeve ndërmjet dëshmitarëve në lidhje me përshkrimin e ngjyrës së veturave dhe numrit të njerëzve në barrikadë, vlerësimi të moshës së tyre, ngjyrës së flokëve të tyre, rrobave të tyre, formave trupore, si dhe ngatërrimit nga F.U. \_\_\_\_\_ në lidhje me mbiemrin e R.R. \_\_\_\_\_ dhe emrit të babait të tij, sepse këto rrethanat qartazi as nuk e përjashtojnë e as nuk e përfshijnë R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_ nga vendi i ngjarjes. Trupi gjykues nuk i duken faktor vendimtar përshkrimet disi të paqarta pasi F.U. \_\_\_\_\_ e njihte shumë mirë pamjen e R.R. \_\_\_\_\_ dhe e njoju atë në

barrikadë. Përveç tjerash, atij i kujtohej pamja e M.V. \_\_\_\_\_ dhe ai e identifikoi atë si personi që ishte te barrikada duke e ndalur konvojin e \_\_\_\_\_ së Kosovës. Kështu që, ishte identifikimi i bërë me shfrytëzimin e albumeve të fotografive, që është vendimtare për identifikimin e të pandehurit M.V. \_\_\_\_\_ në këtë rast.

Sa i përket klasifikimit ligjor të akuzave kundër të pandehurve R.R. \_\_\_\_\_ dhe M.V. \_\_\_\_\_ në pikën 4) të Aktakuzës, trupi gjykues thekson se gjykata nuk detyrohet sipas kualifikimit ligjor të prokurorit të përshkrimit faktik të një vepre në Aktakuzë (neni 360, paragrafi 3 të KPP-së). Sipas pikës 4) të Aktakuzës, të dy të pandehurit janë akuzuar për veprën penale “**Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare**” të përshkruara dhe të ndëshkueshme sipas nenit 316(1) dhe (3) të KPK-së të lexuar në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* e nenit 409(1) dhe (2) të KPRK-së i lexuar në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

Ngjarja e vërtetuar më lart ka ndodhur më 26 korrik 2011, kur ligj në fuqi ishte Kodi Penal i Kosovës, që ka hyrë në fuqi më 06 prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Ai u ndryshuar më 06 nëntor 2008 thjesht duke e ndërruar emrin e tij në Kodi Penal i Kosovës. Megjithatë, Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (KPRK, Kodi nr. 04/L-082) ka hyrë në fuqi më 01 janar 2013.

Trupi gjykues vë në dukje se të dy, kodi i vjetër (KPK) dhe ligji i ri (KPRK), shprehin parimin e rëndomtë në ligjin penal: “Ligji penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale zbatohet ndaj kryesit”. Megjithatë, të dyja ligjet po ashtu e shprehin përjashtimin e pranuar universalisht: “Në rast të ndërrimit të ligjit në fuqi në një rast të dhënë para vendimit të plotfuqishëm, ndaj kryesit zbatohet ligji më i favorshëm”.

Bazuar në Kodin e Vjetër (KPK), vepra e Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, paragrafët 1) dhe 3) përshkruhen në nenin 316 si vijon:

- 1) *Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atqasshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.*
- 3) *Nëse vepra penale nga parografi 1 ose 2 i këtij nenit është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryerësit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.*

Bazuar në Kodin e Ri (KPRK), vepra Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, paragrafët 1) dhe 2) përshkruhen në nenin 409, paragrafët 1) dhe 2) si vijon:

1. *Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*
2. *Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose*

*tenton tē pengojë personin zyrtar nē kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjtë e detyron atë tē kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri nē tre (3) vjet.*

Kështu që, neni 316, paragrafi 1 i KPK-së (Kodi i vjetër) e ndalon pengimin e personave zyrtarë nē kryerjen e detyrave zyrtare “*me dhunë ose me kanosje pér përdorim tē atqasshëm tē dhunës*”. Paragrafi 3 e rrit gamën e dënimit nëse kjo vepër është kryer nē një mënyrë tē caktuar siç përshkruhet. Neni 409, paragrafi (1) i KPRK-së (Kodi i ri) ka një formulim gjuhësor tē ndryshëm, por nē thelb është i njëjtë (“*dhunë ose kanosje tē rëndë*”).

Veprimet e vërtetuara tē **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_** nuk përfshijnë përdorimin e dhunës, kanosjes me përdorim tē dhunës ose kanosjet e rënda. Krijimi i barrikadës tē përbërë nga vetrat ishte një lloj rezistence dhe pengimi pasiv. Nuk është vërtetuar që ndonjëri nga personat nē barrikadë, duke përfshirë tē pandehurit, kanë përdorur dhunë, ose kanë kanosur pér tē përdorur dhunë, ose kanë sinjalizuar me fjalë ose mjete kanosje tē rënda. Me vendosjen e barrikadës ata e kanë detyruar \_\_\_\_\_ e Kosovës tē ndalet, ata refuzuan t'u bindeshin urdhraive tē \_\_\_\_\_ së Kosovës pér ta liruar rrugën dhe i kanë treguar tre gishtërinjtë, ose gishtin e mesit që ishte fyes dhe vulgar, dhe i kanë bërtitur \_\_\_\_\_ së Kosovës. Sipas mendimit të trupit gjykues, këto veprime nuk kanë qenë kanosje që përfshihen nga neni 316, paragrafët 1) dhe 3) tē KPP-së, ose neni 409, paragrafi 1) tē KPRK-së.

Por, aktet e vërtetuara tē kryera nga tē dy tē pandehurit **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_**, siç përshkruhet nē dispozitiv, paraqesin veprën penale tē Pjesëmarrja nē grupin që pengon personat zyrtar nē kryerjen e detyrave zyrtare, që përshkruhet dhe ndëshkohet sipas nenit 318, paragrafi 1 tē KPK-së.

Me tē gjitha këto prova, trupi gjykues mund tē vlerësojë se incidenti ishte i organizuar shumë mirë nē nivel profesional. Ky nuk ishte një veprim spontan. Ka ekzistuar një plan i qartë pér tē penguar \_\_\_\_\_ që tē arrinin te Porta \_\_\_\_\_ me përdorimin e barrikadës së parë, pastaj barrikadës së dytë dhe pastaj ndodhën tē shtënat. Ata i rezistuan forcës \_\_\_\_\_ dhe ishin shumë tē suksesshëm. Ka prova që tërë kjo ishte shumë mirë e organizuar dhe se secili person duhet tē luante një rol nē këtë incident.

Neni 318, paragrafi 1 i KPK-së e përshkruan veprën penale tē Pjesëmarrjes nē grupin që pengon personat zyrtarë nē kryerjen e detyrave zyrtare, si vijon:

*“Kushdo që merr pjesë nē grupin e njerëzve që me veprim tē përbashkët pengon apo tenton tē pengojë personin zyrtar nē kryerjen e detyrave zyrtare ose nē mënyrë tē ngjashme e detyron tē ekzekutojë detyra zyrtare dënohet pér pjesëmarrje me gjobë ose me burgim deri nē tri vjet.”*

Me fjalë tē tjera, sjellja e tyre nē momentin kritik ishte përshkruar dhe paraparë si vepër penale nga Kodi që ka qenë nē fuqi nē kohën e kryerjes së saj. Dhe kjo e ka vazhdimësinë e saj nē kuadër tē nenit 409 paragrafi 2 tē Kodit tē tanishëm, KPRK. Domethënë, **R.R. \_\_\_\_\_** dhe **M.V. \_\_\_\_\_** së bashku me personat e tjerë e kanë bllokuar rrugën me vetura, dhe me këtë veprim tē përbashkët ata e kanë penguar \_\_\_\_\_ nē kryerjen e detyrave tē tyre, gjegjësisht që tē

vazhdonin te Porta \_\_\_\_\_. Gama në fuqi sa i përket caktimit të dënimit është e njëjtë në të dy kodet, të vjetrin dhe të riun: *gjobë ose dënim me burgim deri në tre vjet.*”, në Kodin e vjetër (KPK) në kohën kur kanë ndodhur veprat penale gjegjëse kjo ishte në fuqi.

Duke pasur parasysh parimin e rëndomtë në të drejtën penale: “*Ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale duhet të zbatohet ndaj kryerësit*”, trupi gjykues e gjen të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_ dhe të pandehurin M.V. \_\_\_\_\_ fajtor për Pjesëmarrje në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Ku trupi gjykues e rikualifikon akuzën fillestare të Pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare në shkelje të nenit 316, paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së të lexuar në lidhje me nenin 23 të KPK-së që aktualisht ndiqet penalisht sipas nenit 409 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së të lexuar në lidhje me nenin 31 të KPRK-së në një mënyrë që e kualifikon veprën penale të kryer nga të pandehurit si vepër penale të “**Pjesëmarrjes në grupin që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare**”, të përshkruar dhe të dënueshme sipas nenit 318, parografi 2 të KPK-së. Vepra penale e përmendur që ata kanë kryer me dashje direkte sepse ata kanë qenë të vetëdijshëm për aktin e tyre dhe e kanë dëshiruar kryerjen e saj, qëllimi i tyre ishte që ta pengonin \_\_\_\_\_ e Kosovës që të arrinte te Porta \_\_\_, dhe ata ia dolën ta arrinin atë qëllim. Bazuar në këtë, të dy të pandehurit janë dënuar për atë vepër penale të veçantë, siç thuhet në dispozitiv. Këtu duhet të nënvozohet se me nenin gjegjës kërkohet që kryerësi “të merr pjesë në grupin e njerëzve që me veprim të përbashkët...”. Si pasojë, nuk është e domosdoshme të zbatohet “bashkëkryerja” sipas nenit 23 të KPK-së ose nenit 31 i KPRK-së.

### **Caktimi i dënimit**

Sipas rregullave të përgjithshme për matjen e dënimive në nenin 64 të KPK-së: “Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënnimi duhet të jetë në proporcione me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”.

Si rrethana rënduese për të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, gjykata e konsideroi se ai tashmë e ka kryer dhe është dënuar për veprën shumë të rëndë penale të vrasjes. Më tej, trupi gjykues po ashtu, si rrethanë rënduese për R.R. \_\_\_\_\_ e merr parasysh veprën penale që ka ndodhur më 26 korrik 2011, dhe se ai ka qenë në arrati deri më 11 prill 2014 kur ishte arrestuar. Në lidhje me të dy të pandehurit, trupi gjykues e konsideron si rrethanë rënduese se pengimi i konvojit të \_\_\_\_\_ së Kosovës ishte kryer për të penguar \_\_\_\_\_ në marrjen e kontrollit mbi Portën \_\_\_\_\_ (stacioni kufitar) në një kohë kur gjendja ishte shumë e tensionuar në zonë ndërmjet shumë \_\_\_\_\_ të Kosovës dhe autoriteteve të Kosovës, e sidomos \_\_\_\_\_ së Kosovës. Ngritja e barrikadës dhe pengimi i konvojit detyrimisht do ta përshkallëzonin më tej gjendjen tashmë të tensionuar.

Në anën tjeter, trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë lehtësuese në lidhje me të pandehurin R.R. \_\_\_\_\_, e as në lidhje me të pandehurin M.V. \_\_\_\_\_.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura në lidhje me të pandehurin **R.R.** \_\_\_\_\_, veprën penale që ai ka kryer, pasojë e kryerjes së veprës gjegjëse, fakti se ai ka vepruar me dashje direkte, si dhe gamën në fuqi për caktimin e dënimit, trupi gjykues e ka dënuar **R.R.** \_\_\_\_\_ me 2 (dy) vjet burgim. Në pajtim me nenin 43, paragrafi (1) dhe nenin 44, paragrafi (2) të KPK-së, ky dënim nuk ekzekutohet nëse i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ nuk kryen ndonjë vepër tjeter penale për një periudhë verifikimi prej 4 (katër) vjetësh. Gjykata beson se në këtë rast, qëllimi i dënimit mund të arrihet me zbatimin e dënimit me kusht pa ekzekutim të dënimit me burg. Dhe po ashtu, gjykata mendon se periudha e verifikimit prej 4 vjetësh është mjaft e gjatë për të për ta ndryshuar sjelljen e tij në mënyrë pozitive. Bazuar në nenin 73, paragrafi (1) të KPK-së, koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria lidhur me të pandehurin **R.R.** \_\_\_\_\_, përkatësisht prej 11 prillit 2014 deri më 22 prill 2015 llogaritet në dënimin me burgim në rast të revokimit të dënimit me kusht dhe të ekzekutimit të dënimit.

Duke marrë parasysh rrethanat rënduese të cekura në lidhje me të pandehurin **M.V.** \_\_\_\_\_, veprën penale që ai ka kryer, pasojë e kryerjes së veprës gjegjëse, fakti se ai ka vepruar me dashje direkte, si dhe gamën në fuqi për caktimin e dënimit, trupi gjykues e ka dënuar **M.V.** \_\_\_\_\_ me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. Në pajtim me nenin 43, paragrafi (1) dhe nenin 44, paragrafi (2) të KPK-së, ky dënim nuk ekzekutohet nëse i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ nuk kryen ndonjë vepër tjeter penale për një periudhë verifikimi prej 3 (tre) vjetësh. Gjykata beson se edhe në këtë rast, qëllimi i dënimit mund të arrihet me zbatimin e dënimit me kusht pa ekzekutim të dënimit me burg. Periudha e verifikimit prej 3 vjetësh është mjaft e gjatë për të për ta ndryshuar sjelljen e tij në mënyrë pozitive.

### **Shpenzimet e procedurës**

Trupi gjykues i shpall fajtor të pandehurit **R.R.** \_\_\_\_\_ dhe **M.V.** \_\_\_\_\_ për veprën penale të Pjesëmarries në grupin që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, dhe bazuar në nenin 453, paragrafi (1) të KPPK-së, secili prej tyre obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale. Duke marrë parasysh numrin e seancave të mbajtura dhe gjendjen ekonomike të të pandehurve, gjykata vendosi që bazuar në nenin 451, paragrafi (1) dhe nenin 453, parrafat (1) dhe (4) të KPP-së, i pandehuri **R.R.** \_\_\_\_\_ detyrohet të paguajë 400,00 (katërqind) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga obligimi që të paguajë shpenzimet e mbetur. Gjykata vendosi që i pandehuri **M.V.** \_\_\_\_\_ detyrohet të paguajë 300,00 (treqind) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga obligimi që të paguajë shpenzimet e mbetur.

Të pandehurit duhet që shumë e urdhëruar ta paguajnë jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim e merr formën e prerë.

### **Kërkesa pasuroro-juridike**

Gjatë seancës së shqyrtimit të 10 tetorit 2016, përfaqësuesi i palës së dëmtuar, Z. Burhan Maxhuni dorëzoi deklaratat për dëmin për palët e dëmtuara, Znj. D.Z. \_\_\_\_\_, Z. B. M. \_\_\_\_\_ dhe Z. D.P. \_\_\_\_\_.

Në deklaratën e saj të datës 19 shtator 2016, pala e dëmtuar Znj. D.Z. \_\_\_\_\_ deklaroi se vepra penale ka pasur efekt financiar. Trajtimi mjekësor i kishte kushtuar asaj pesëmijë e treqind (5300) euro, dhe kërkoi këtë shumë që ajo si e ve, dhe \_\_\_\_\_ fëmijët e saj kanë të drejtë sipas ligjit.

Në deklaratën e tij të datës 05 tetor 2016, pala e dëmtuar, Z. B.M. \_\_\_\_\_ nuk i ka specifikuar shpenzimet e trajtimit mjekësor. Ai ka deklaruar se efekti i veprës penale është i pamë, që shkakton ndjenjat e frikës, ankthit, pagjumësisë, vështirësive në përqendrim, rishfaqje e vazhdueshme e ngjarjes.

Në deklaratën e tij të datës 19 shtator 2016, Z. D.P. \_\_\_\_\_ nuk i ka specifikuar shpenzimet e trajtimit mjekësor, ai deklaroi se gjatë incidentit ai ishte në veturë me kolegut e tij E.Z. \_\_\_\_\_, që nga ai moment ai kishte përfjetuar parregullsi sa i përket pagjumësisë dhe ishte bërë person më nervoz.

Pasi që, gjykata nxjerr aktgjykim lirues ndaj të pandehurve për veprën Vrasje e Rëndë të E.Z. \_\_\_\_\_, bazuar në nenin 463, paragrafi (2) të KPP-së, pala e dëmtuar D.Z. \_\_\_\_\_ ftohet të parashtrojë çfarëdo kërkese për kompensim në lidhje me këtë rast përmes gjykatave civile. Më tej, palët e dëmtuara B.M. \_\_\_\_\_ dhe D.P. \_\_\_\_\_ të cilët gjithashtu kanë paraqitur kërkeshat e tyre pasurore ftohen të parashtrojnë çfarëdo kërkese për kompensim në lidhje me këtë rast përmes gjykatave civile sepse të dhënat e mbledhura në procedurën penale nuk ofrojnë bazë të besueshme qoftë për shpërblim të plotë ose të pjesërishtëm.

Mitrovicë, 21 nëntor 2016

---

Kryetarja e trupit gjykues nga EULEX-i  
Iva Niksic

**KËSHILLË JURIDIKE:** Palët kanë 15 ditë kohë nga dorëzimi i këtij aktgjykimit për të ushtruar ankesë në pajtim me nenin 380, paragrafi (1) dhe nenin 381, paragrafi (1) të KPP-së. Çdo ankesë duhet të paraqitet në gjykatën e shkallës së parë sipas nenit 388, paragrafi (1) të KPP-së.